

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 256, Shkurt 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Viti 2025, 100-vjetorit të lindjes së Albanologut Martin Camaj "Nderi i Kombit"

GJENERAL PETRITI ÇUNI,
"NDERI I SHOQATËS ATDHETARE
DUKAGJINI" SHTON MBI SUPE
NJË YLLË TJETËR GJENERALI -
GJENERAL MAJOR



**KAPITEN
VIKTOR
ARRINAJ, SOT
PRESIDENTI
I KOMPANISË
"XHOVANI - 4"
SHPK** **2**



Viktori ka lindur me 8 mars 1965, në Shkodër, i biri i Kole Nosh Arrinaj nga fshati Plan i krahinës së Pultit, dhe File Shtyt Arrinaj, bije e fshatit Theth, të krahinës së Shalës. Në vitin 1976 mbaroi shkollën fillore shkëlqyeshëm, në Breglumi të Shalës. Në vitin 1976 - 1980 mbaroi shkollën 8 vjeçare, në Grude të Re, një nder nxënësit më të mirë të shkollës, me nota maksimale.



**JETËSHKRIM I
SHKURTËR PËR
P.JUSTIN RROTA**

(BIOGRAFI, NGA P. DONAT KURTI, SHKODËR - DHETUER 1964)

Me 17 shkurt 2025, Padër Justin Rrota, "feston" në Amshim, 136 vjetorin e lindjes, që e bëri të pavdekshëm.

Padër Justini (Ndoci) kje i treti fëmijë nder gjashtë (katër vëllazën e dy motra), që leu me 17 Fruer 1889 në Shkodër, prej Gjushit të Gjon Qerraxhis (Rrota) e prej Shaqes së Jak Vjerdhës. Kje pagëzue me 18 Fruer prej D. Ndoc Nikaj e i kje ngjitë emni Ndoc.

Fill mbas azilit, që pat bënë Tina e Nikës në Serreq, u shkruie në Shkollën Françeskane, ku kreu pesë klasë filllore e një klasë qytetze. Mundi e kujdesit të mësuesve të vet u përgjegji me sjellje t'urtë e me zell nder mësim. I butë per natyrë,

Kapiten Viktor Arrinaj, sot Presidenti i Kompanisë “Xhovani - 4” shpk

Kush është kapiten Viktor Arrinaj?

Viktori ka lindur me 8 mars 1965, në Shkodër, i biri i Kole Nosh Arrinaj nga fshati Plan i krahinës së Pultit, dhe File Shtyt Arrinaj, bije e fshatit Theth, të krahinës së Shalës.

Në vitin 1976 mbaroi shkollën fillore shkëlqyeshëm, në Breglumi të Shalës.

Në vitin 1976 – 1980 mbaroi shkollën 8 vjeçare, në Grude të Re, një nder nxënësit më të mirë të shkollës, me nota maksimale.

Kushtet ekonomike e detyruan të futet në shkollën e mesme industriale, pa shkëputje nga puna, dhe vetëm në moshën 14 vjeçare filloi punën në fermën e Shtojtit dhe e vijoi për 5 vite me radhe derisa e mbaroi shkollën e mesme.

Viktori, në vitin 1976 shkon në shkollën ushtarake për oficer rezerve dhe për të mos u kthyer më në ferme, thotë Viktori: “I vura vetes detyre dhe e përfundova me notën mesatare 9.7, emërohem oficer aktiv dhe mbas një viti punë, shkova një vit në akademinë ushtarake, në shkollën e bashkuar në Tiranë, pastaj punova tete vjet, deri në fund të vitit 1990, në detyrën e komandantit të togës dhe tre vitet e fundit në detyrën e komandantit të baterisë kundërajrore”.

Viktori, kur pyetet mbi punën e tij drejtuese, thekson: “Isha një oficer rebel, liberal, por dhe i afte, i kujdesshëm dhe me respektin e ndërsjellët me të gjithë koleget, eprorë e vartës, në veçanti me gjithë ushtarët, në atë kohë nga krejt Veriu, që edhe mbas 32 viteve, kam plotë komunikim me ta”.

Në vitin 1991 martohet me Albana Pepa, e bija e Gjergj e Marije Pepes, dhe kane tre fëmijë: Fjoleren, Xhovanin e Robertin.

Viktori rrëfëhet: “Pas martesës largohemi nga pallati i tejmbushur në Grude të Re dhe i dëmtuar nga tërmeti i 79-nes, vendosemi në një barakë, në lagjen “Partizani”, në të cilën jetuam pesë vite. E falënderoj me gjithë zemër bashkëshorten, për durimin e pese viteve vuajtje, fukarallëku në kulm, në kushte mjaft të këqija jetese, por dhe me keqtrajtime, duke qene të mbushur me bixhoz, baste e pije pa fund, jo në pak raste dhe me ngatërresa nëpër lokale, i mbushur me ankth e urrejtje për gjendjen e keqe të jetesës dhe për pamundësinë për të përmirësuar kushtet e jetesës familjes”.

Viktori vijon: “Në atë kohë të gjithë vëllezërit ishin largua për në Itali, Greqi e Gjermani, lanë gratë, fëmijët dhe pleqtë. Isha vetëm, kushtet e mjerueshme ekonomike, më detyrojnë të punësohem në polici, në cilën punova një vit (police roje objektsh). Mbas 7 viteve shumë të suksesshme, me detyrën e oficerit, me gradën kapiten, u detyrova të punoi në Polici, në detyrën e policit të thjeshtë, duke më trajtuar njësoj, si në kohën e Enverit, me luftime klasash. Në këto kushte u largova nga kjo detyre e policit, lashë bashkëshorten, me dy fëmijë e dy prindërit e mije, vajzën e vogël, djali ishte vetëm dy muajsh dhe

vendosa jashtë çdo logjike e shkova në Greqi. Atje punova tre muaj, në ndërtim, një përvojë, e cila me vlejti sa tre fakultete në Shqipëri. T’ju them të drejtën aty për here të pare mu kujtua një thënie, në veprat e Enver Hoxhës, shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, megjithëse të gjitha vuajtjet ishin pasojë e udhëheqjes komuniste. Mbas kthimit takova të parin Babën. Lotët e tij më detyruan të betohem para Zotit, që sa të kem gjalle Babën e Nenën nuk do të largohem nga Shqipëria edhe në qoftë se do vdes për bukë”.

Dhe ky premtim u mbajt më së miri, mbasi punuam e jetuam për 30 vite gjithmonë këtu, në Shkodër, ku jemi dhe do të jemi edhe në të ardhmen.



Familja Arrinaj. Nga e majta në të djathtë: Roberto, Viktori, Floreta, Albana e Xhovani

Një bisedë me z. Viktor, me rastin e Njëzetë (20) vjetorit të formimit të Kompanisë “XHOVANI-4” – shpk.

Me këtë rast, Viktor Arrinaj, President i kësaj kompanie, prezanton ecurinë e këtyre 20 viteve punë, në një ceremoni shumë modeste e të sinqertë, festive: Vetëm punë e punë pa u ndalur asnjëherë drejt progresit, në mes të tjerave theksoj:

Ne, që krijuam biznesin e pagëzuar me emrin “XHOVANI – 4” shpk. dhe po mundohem të ju tregoj më vonë se, si mbas 10 viteve veprimtari ekonomike të vogël, lindi “XHOVANI – 4” shpk, me 20 janar 2005.

Origjina jonë vjen nga një fisi i madh, fisi i Dodajve të fshatit Plan të krahinës së Pultit, i ndamë në kohën e komunizmit në tre fise, fisi Leraj, fisi Bungaja dhe fisi Arrinaj (Enveri, në atë kohë i kishte frike fiset e mëdha).

Gjashtë vëllezër Arrinaj vijnë nga Nosh Nikë Arrinaj: Kolë – Leka – Lulashi – Marku – Gjoni dhe Frani Arrinaj, që ishin dhe janë shembulli më i mirë i vëllazërisë, e cila u përcoll më së miri në brezat në vijim.

Nga vëllai i madh, Kola, i pari me bash-

këshorten, File Shtytja - Arrinaj vijnë në jete pese djem dhe nje vajze: Violeta, Gjovalini, Tonini, Nikolini, Viktori dhe Valentini.

Në Breglumi të krahinës së Shalës, linden Vjoleta, Gjovalini e Tonini; ndërsa Nikolini, Viktori e Valentini linden në Shkodër.

U rritëm, me babën kryetar këshilli dhe Deputet dhe nenën kuzhinierë, por me mjaft skamje, të barabarte me shtresat më të varfra, si shumica e popullsisë në atë kohë.

Rreth viteve 1976, mbas dhjetë vitesh lutjesh shtetit, nena dhe baba zbriten në Grude të Re. Babës tonë mbas 3 legjislaturash deputet

tar në kufi, me pak ndërhyrje, më erdhi lajmi që do të shkoja në një shkollë ushtarake, në Lac – Vau Dejes, dhe për të mos u kthye me punëtor në fermë, i vura vetes detyrë të mësoj dhe të stërvitem sa më shumë, dhe kështu e përfundova atë shkollë ushtarake, me notën mesatare me 9,7 në dy vitet bashke, thekson Viktori.

Viktori vijon: “Nga mesatarja, por dhe biografia e mirë për kohën, u titullova oficer aktiv, komandant toge te “Pularia”. Mbas 3 viteve punë aty (me anë të një miku B, S.) shkova dhe mbarova dhe nje vit akademi ushtarake në Tiranë, vijova detyrën e oficerit për afër 7 vjet (tre vitet e fundit, në detyrën e komandantit të baterisë kundërajrore në Rrence-Luginë) deri në vitin 1993, Në tërësi kam qene oficer rebel, shume liberal, por dhe i afte, i kujdesshëm në punët dhe shërbimet me armë, me shumë respekt të ndërsjellët me të gjithë oficeret, kryesisht dhe me ushtarët, në atë kohë nga krejt veriu, të cilët edhe mbas 32 vitesh kam plot komunikim”.

Viktori, në vitin 1991 martohet me Albana Pepaj Arrinaj, ikim menjëherë nga pallati i tejmbushur në Grude të Re dhe hyjmë pa leje nga askush, por e vetmja zgjidhje për atë kohë, në një bajrakë ushtarake, në lagje “Partizani”, në të cilën jetuan plotë 5 vite.

Viktori, thekson: “E falënderoj me gjithë zemër, bashkëshorten time, Albanën, për durimin, 5 vite vuajtje, fukarallëk, kushte mjaft të këqija, por dhe keqtrajtim, duke qene të mbushura nga unë, me bixhoz, baste e pije pa fund, jo në pak raste edhe me ngatërresa neper lokale, i mbushur me ankth e urrejtje, për kushtet e këqija, vuajtje dhe për pamundësinë, për ti përmirësuar jetën familjes, jo për fajin tonë”.

Në atë kohe të gjithë vëllezërit ishin larguar për në Itali, Greqi e Gjermani, duke lanë gra e fëmijë e pleq. Viktori vijon: “Isha i vetëm dhe mbasi provova nje vit pune në polici, duke më trajtuar njësoj si në Kohën e Monizmit, me luftime klasash, desh zoti e lashë policiclekun, lashë bashkëshorten me dy fëmijë e dy pleq, vajzën shumë te vogël dhe djalin vetëm dy muajsh, mora vendim jashtë çdo logjikë. Ika në Greqi, punova në ndërtim rreth 3 muaj, Puna aty me vlejti sa tre fakultet. U them të drejtën aty, për herë të pare mu kujtuam veprat e Enver Hoxhës, shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, megjithëse të gjitha vuajtjet ishin pasojë e udhëheqjes komuniste”.

Viktori, mbas kthimit takon të parin Babën Kolë, atij i rrodhen lotët në sytë, dhe në ato momente betohet para Zotit: “Sa ti kem prindërit gjalle, babë e nanë, kurrë nuk do të largohem nga Shqipëria edhe po cofa për bukë”. Ashtu veprovua, dhe desh fati i mirë të vijoi punën e jetën këtu edhe sot.

Viktori vijon rrëfimin e tij: “Zoti ma shpërblej me shëndet, fat e mbarësi, gjate këtyre 30 viteve, më dha gjithçka që kërkova nga jeta, gjene më të shtrenjte, nje familje ideale, ▶

◀ një bashkëshorte me tre fëmijë të përsosur dhe shumë ngadalë me këmbë në tokë, por dhe me shumë djerse e mundime, një pasuri të mjaftueshme, që as nuk e kisha imagjinuar asnjëherë.

Viktori, në fillim të vitit 1995, nga kjo bajrakë filloi biznesin e vogël, ambulancë, me Ilir Arrinaj.

Viktori, thekson: “Dua të ju them një të vërtetë, që ndodh këtu te ne, kryesisht, mbas pak muajve punë, unë zmadhova portën për të futur një veturë në oborr, të gjithë fqinjët kanë qeshur, u çuditën, por në fakt, vetëm mbas 6 muajsh pune ditë e nate, po nga ajo portë futa një “240-sh Benc veturë, dhe vetëm mbas pak vitesh ja fala komshiut komplet barakën, me porte e oborr pa asnjë kafe.

Viktori vijoi punën me Ilir Arrinajn rreth 5 vite bashke ortak, shokë, kushërinj nga baba e nga nena, vëlla e shok i mrekullueshëm, nder njerëzit më të sinqerte e besnik, nga më punëtorët e korrekët, që ka njohtë në jetë, duke u pa drejt në sy për çdo punë, duke kuptuar e mbështet njeri - tjetri si askush, por duke punuar dite e nate pa pushim, pa asnjë ankese a pakënaqësi ndaj njeri - tjetrit.

Viktori vijon tregimin, për punën që ka bërë e bën me shokët e tij:

* Me Prekë Gjonaj, një shok i ngushtë e kushëri, por njeriu më i edukuar e korrekt që kam njohtë, modeli më i mirë i shokut, kushëririt, familjarit e bashkëpunëtorit, na mbështeti deri në fund të qëndrimit në Shqipëri, me qetësinë e mençurinë e tij, sot jeton i lumtur në Kanada.

* Me Gëzim Palin, gjithmonë punëtor e shumë besnik, i palodhur asnjëherë, i cili më shoqëroi në ditë të mira dhe në ditë shumë të vështira dhe fatmirësisht vijojmë bashke.

* Me Niko Berishën, shok i mirë e gjithnjë me këmbë në tokë;

* Me axhën Gjon, një burrë i dashur dhe shumë zotëri, që na mbajti gjithmonë të qeshur me humorin e tij, dhe me disa shokë të tjerë, që të më falin se, nuk po ju përmend me emra.

Vetëm mbas një viti me biznes bleva një aparat në lagjen “Skënderbeg” dhe për 5 a 6 vite jetova aty i lumtur me familjen time. Në këto vite të biznesit pata edhe mbështetjen, që nuk mund ta harroj, të dy vëllezërve të mi, Nikolinit dhe Valentinit, që gjithë paret e fituara vetëm me djersën e ballit m’i besuan mua, që ti administroja, megjithëse Nikolini ishte më i madh se unë në moshë, nga Tonini mora gjithmonë mbështetje morale, për besimin dhe mbështetjen që më dhanë gjithë atë kohë shumë të vështirë, për mua, Ju jam mirënjohës gjithë jetën time.

Kemi aq shumë për të tregu nga ky rrugëtimi i gjatë, sa do na duheshin ditë e natë me fol për suksese, dështime, ulje e ngritje, për borxhe të pa fund të marruar nga ne, me interes e pa interes, deri në 10% me interesa në muaj, por dhe plot borxhe të pa likuiduar nga të tjerët ndaj nesh. Në këto kushte, në vitin 1999 – 2000 largohem nga pallati, duke e shite dhe me ato pare bashke me vëllain e ardhur nga Gjermania, Valentinin blejmë token 1000 m², sot e ndajmë përgjysmë dhe me Gëzim Palin, djalin që ju foli më sipër dhe Valentinin, vëllain, në atë kohë beqar, por një djalë korrekt, i dashur e punëtor (jo se nuk është sot), mjeshtër në profesionin

fituar jashtë, në Greqi e Gjermani, por që vjen edhe me një mentalitet perëndimor, e cila na mungonte, mbasi mora një përvojë mjaft të vlefshme për 5 vite punë, në Mal të Zi, duke pa që Shqipëria ishte ende e shkatërruar nga komunizmi, por edhe nga ngjarjet e vitit 1997-tes.

* Në vitin 2000, rifillojmë biznesin tashme në Shkodër me 20 m² dyqan, me mall e pa mall, megjithëse ishin aq të varfër sa për një vit nuk nxorëm as rrogat tona, por me durim e besim në ZOT – kjoftë lëvdua, duke punuar, duke i shërbyer me sinqeritet pa i bërë hile askujt (me dashje), tujë u rrite me punë dhe ngadalë tujë u afrua te gjithë këta persona, motra dhe vëllezër, shoke te vjetër dhe besnike, që për mua ja vlen ti përmendi dhe t’i falënderoj një për një si:

* Ilir Arrinaj, një person i radhe, që foli më sipër na bashkohet në detyrën e shitësit e menaxher i nderuar dhe i respektuar mbi 25 vite;

* Nikolin Arrinaj, vëllai i cili gjate viteve që punoj në Greqi, më mbështeti



Personeli i punës në firmën “XHOVANI – 4”

me të gjitha mundësit e tij financiare, fillon punën me ne, për më shumë se 20 vite, në krye të shitjeve, në detyrën e drejtorit, gjithmonë në këmbë, i pa lodhur, tepër korrekt dhe i sinqerte, i cili mban peshën kryesore të punës dhe shitjeve edhe sot, me Xhovanin e Bobin;

* Agim Çokaj, një nder shtyllat kryesore të firmës, një djalë, i cili dinte të ndaj mese miri shoqërinë me punën, specialist, me duar të arta, që dinë të bëj mesë miri çdo profesion, bashke me bashkëshorten Valbona Çokaj, një punonjëse shembullore, që në sajë të punës së saj, ka shkëlqyer për rreth 20 vite dhe vijon edhe sot;

* Motra ime, Vjoleta për disa vite, në funksionin e ekonomistes, e sakte, shumë e dashur dhe e sinqerte, shembullore në të gjitha drejtimet, shkurt nuk ka si motra për vëllain;

* Vjen Albana, bashke me vajzën time, Fiorelen 15 vjeç, të më falin të gjithë, sepse me duket se nuk kishte shoqe, aq e mirë dhe e pjekun, e përkushtuam, e kujdesshme dhe vëmendshme filloi punën që në atë kohë, vijon sot mjaft e suksesshme dhe shembullore me familje e biznesin e vet në Miçigan të SHBA, që e ndërtoj, me punën e vet e të bashkëshortit.

* Bobi, në këto vite ishte 12 a 13 vjeç,

rrinte në zyrë me mua, kudo më ndiqte, shumë simpatik, inteligjent dhe i vëmendshëm në gjithçka, gjithmonë më shikonte, herë herë edhe me korigjonte.

* Xhovani luante futboll dhe unë paguaja fushën, xhupat e ekipit dhe rrugët e punën e profesorëve, por fatmirësisht mbasi e binda, se futbolla nuk ishte e ardhmja për të gjithë, dhe nuk e kishim tradite si fis, kthehet në punë para 10 vitesh, me shumë dëshirë e vull për krahu axhës Nikolin, Ilirit e Gëzimit bën pa përbuzje, me shumë dëshirë çdo punë sado të rënda të ishin, perfeksionohet çdo ditë e më shumë dhe sot është pothuaj në krye të punës, një djalë model e shumë i afte në tanë aspektet, i trajnuam me shumë vlera, me aktivitet e specialist të fushës, i mbështetur nga Bobi, në fushën e financës, në të cilën vete Bobi është shkolluar, vijojnë punën çdo ditë, duke u rrite ngadalë, por të sigurte.

* Sot kemi dhe Mirsad Hallunaj një djalë punëtor, i ndershëm, profesionist i vërtetë, që po ecën me shumë sukses në

me Zotin;

*5. Gjovalin Pepa, i ndjeri kjoftë mirë, me Zotin;

*6. Kumara im, Sander Vulaj, shokë dhe mik i vjetër;

*7. Vera Vulaj, bashkëshortja e Sandrit, shitëse shembullore, grua e nene shembullore.

*8. Nazmi Lisi punëtor i pa lodhur e shembullor;

*9. Ndoc Koçeku, i dashur me shokët, i veçantë në llojin e tij;

*10. Pëllumb e Fatmir Frashnishta, vëllezër, që punuan për disa kohe në “Xhovani-4”.

Respekt, mirënjohje dhe falënderim për të gjithë këta bashkëpunëtor, dhe disa të tjerë, që punuan qofte vetëm një ditë, në “Xhovani-4” shpk dhe për arsye të ndryshme, nuk janë më pjese e punës tonë.

Ne, duke pare, që është shumë e vështirë të rritemi të pavarur nga tregu i brendshëm dhe që çdo ditë rritej kërkesa, në Vitin 2005 krijojmë biznesin e pagëzuar me emrin “XHOVANI – 4” shpk, fillojmë importin e pare, me rreth 300 mijë \$ (të gjitha të marruna kredi, në një banke), marr vizën dhe shkoj në Kinë, dhe pasi zgjedh një fabrike me materialet, të cilat na interesonin ngarkoj atje dhe nisëm, për në Shkodër “7 kontejnerë”, por pa menduar, që ka pengesa edhe nga vete shteti ynë, duke deklarua gjithçka deri te një vide, mbasi i kishim pagua shtetit çdo detyrim ligjor, tete ditë e natë na bllokojnë në doganën e Durrësit, me të gjithë mallin rreth 280 m³ në tokë, kontroll mbas kontrolli, por mbasi ishim në të drejtë te Zotit, ja dolëm, megjithëse nuk na u nda antikotrabanda e asaj kohe për dy vjet me radhe, për disa vite vijum importet me Kinën, por dhe me Italinë, duke u rrite mjaft ngadalë, por të sigurte, çdo ditë duke u shtua klientët të vegjël e të mesëm, por dhe firmat ndërtuese, kështu na detyruan të largohemi rreth 1 km dhe të zgjerohemi në këto përmasa, që jemi edhe sot, 1400 m² eksporte dhe rreth 3000 m² magazina.

Për të ardhur në këtë standardë u deshën më shumë se 25 vite, duke blere pjesë - pjesë me të pritur e me këste, disa prona toka e objekte, që i falënderojmë gjithë ish pronaret, të cilët na besuan, në veçanti Vehbi Grudën, vëllezërit Kocaj, Enver Xhilaj, shok i vjetër, të cilët na besuan në kohet më të vështira të ekzistencës apo jo të biznesit tonë, shpesh shokë e miq na pyesin dhe me të drejte nga vjen ky emër:

Ajo, që na nxiti, për ta pagëzuar këtë biznes, me emrin “XHOVANI – 4”, është vëllai, Gjovalini, që ishte nda nga jete, në vitin 1985, unë besova në Zot, që do të më jepte një djalë, për të pas një emër në kujtim të vëllait. Në fakt fëmija i parë më lindi një yll drite, vajzë, që më bëri babë dhe më besoni, se e desha dhe e dua shumë, më shumë se jetën time, por shpresova në Zot dhe ma fali edhe dy artistë Xhovanin dhe Bobin.

Ne këto kushte ekonomike, pa shtëpi mbi koke, por ne një moshe tepër energjike, ju shtrova punës dhe për 10 vite me radhe nuk kam ditur çfarë dite është sot apo nesër, e hane apo e marte, është dite apo është nate, vetëm punë pa ndalur, për të mbajtur familjen, për ti rritur e siguruar kushte sa më të mira jetese, mbrapa për të ndërtuar, për të mbajtur në këmbë e për ta rrite biznesin,

shitje dhe gjithçka tjetër;

* Senadin një djalë punëtor, i edukuar dhe që çdo ditë përmirëson punën e tij;

* Kështu dhe Besmir Arrinaj e Gjergji Vata, punëtor të palodhur dhe pa fjale;

* Mbesa jonë, Eliona, një vajze e urte e edukuar, punëtore e sinqerte, që po punon dhe komunikon me njerëzit, në mënyrë shembullore çdo ditë e më mire;

* Nuk mund të harroj Murat Pashain një burrë që nuk njeh moshë, i cili për 10 vite rresht i jep çdo ditë energji pozitive krejt ekipit, këshilltar e mik i mirë.

* Në këtë udhëtim të gjatë na shoqëruan edhe shumë djem e vajza, burra e gra shumë të mire, që i falënderoj, si me poshtë:

*1. Gjovalin Frashnishta, një djalë dajë, një djalë tepër korrekt dhe punëtor i gjithanshëm, modeli më i mirë i një djali të moshës që kishte. Ai, për disa vite largohet për në Angli, në 10-vjetor e vlerësuam me “Topin e Artë”;

*2. Danjela Paci, një vajze shumë e edukuar e korrekte, së cilës i urojme sukses në punë e në jetë;

*3. Lazer Marku, shokë i joni femërie, që për disa vite ishte shumë punëtor dhe korrekt;

*4. Bardh Ivziku, i ndjeri kjoftë mirë

GJENERAL PETRITI ÇUNI, “NDERI I SHOQATËS ATDHETARË DUKAGJINI” SHTON MBI SUPE NJË YLLË TJETËR GJENERALI - GJENERAL MAJOR -

Kjo foto daton në vitin e largët 1985, kur djaloshi i imët kishte pak muaj që kishte nisur rrugëtimin e karrierës ushtarake. Vitet kalonin e Skënderbegasi rritej, maturohej dhe projektonte të ardhmen e tij në shërbim të atdheut.

Në shkrime të mëparshme në numrat e kësaj gazete, por edhe në botime të tjera është shkruar për karrierën brilante dhe arritjet e djaloshtit nga fshati Gimaj, të krahinës së Shalës. Petrit ÇUNI.

Sot në këtë pasazhe të shkurtër po risjellim shkurtimisht ecurën e rritjes në grade të Gjeneral Çuni-t.

Në vitin 1992 Gradohet Nëntoger

Në vitin 1994 Gradohet Toger

Në vitin 1995 Gradohet Kapiten i Parë

Në vitin 2004 Gradohet Major

Në vitin 2009 Gradohet Nënkolonel

Në vitin 2016 Gradohet Kolonel

Në nëntor 2021 me Dekret të Presidentit të Republikës i jepet grada madhore Gjeneral Brigade.

Përgjatë 32 viteve karrierë në detyrën e oficer aktiv në forcat e Armatosura Shqiptare, Gjeneral Çuni ka kryer një spektër të gjerë detyrash, duke filluar nga niveli taktik, në operativ e deri në nivel strategjik.

Ka përfaqësuar Shqipërinë dhe forcat e Armatosura Shqiptare, në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare, në nivele të ndryshme shkollimi jashtë Shqipërisë (kryesisht në Gjermani, në të cilin ka kryer kualifikime nga niveli taktik, strategjik dhe deri në studime të avancuara në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Nga rezultati i C.V-së, detyrave dhe nivelit mjaft profesional të tij, Gjeneral ÇUNI atëherë me gradën N/kolonel) në harkun kohor 2013-2016 kishte angazhimin e tij të parë në Strukturën Komanduese të NATO-s, në detyrën e Shefit të Degës së Menaxhimit dhe Administrimit në Komandën e Forcës Bashkuar në Brunssum Holandë dhe përfaqësues Ushtarak Kombëtarë në këtë Strukturë. Detyrë, e cila do shtronte rrugën për promovim në gradën Kolonel dhe më pas e ndjekur nga emërimet, në detyra mjaft të rëndësishme, në Forcën Tokësor (Shef

Shtabi), në Shtabin e Përgjithshëm (Drejtor i Shtabit) dhe në Ministrinë e Mbrojtjes (Drejtor në NATO, BE dhe në Marrëdhëniet me Jashtë).

Pas këtyre detyrave mjaft prestigjioze dhe të vlerësuara dhe nisur nga rezultatet

detyrë mjaft të rëndësishme përfaqësimi përsëri në NATO, kësaj here Përfaqësues Ushtarak Kombëtar në Komandën Strategjike të NATO-s Mons Belgjikë (Korrik 2019).

Duke qenë në këtë pozicion Gjeneral

gjithë personelin ushtarak shqiptarë, që shërbente në strukturat e Komandës dhe ato të Forcës së NATO-s.

Vlerësimi e përkushtimi, profesionalizmi dhe shërbimit ndaj atdheut dhe FARSH, puna dhe karriera e tij prek nivelin më të lartë, atë të promovimit në gradën madhore Gjeneral Brigade (26 Nëntor 2021).

Arritje, që çdo ushtarak e ëndërron ta ketë në supet e tij dhe që përbën një pikë kulmore dhe të shkëlqyer të karrierës. Pas këtij vlerësimi dhe arritje të jashtëzakonshme, shenjë e vlerësimit të punës dhe rëndësisë së këtij pozicioni, lidhshipi politik dhe ushtarak riemëron (rikonfirmim) Gjeneral Brigade ÇUNI, në detyrën Përfaqësues Ushtarak Kombëtar në Komandën Strategjike të NATO-s, në Mons Belgjikë edhe për një mandat të dytë trevjeçarë (2022-2025). Ky mandat do të përkonte me kohën kur sistemi, struktura e Sigurisë globale u përball me kërcënimin më të madh, që pas përfundimit të luftës së ftohtë dhe po ashtu NATO, struktura më e fortë dhe më e suksesshme politike ushtarake në histori, u vu përballë këtyre sfidave dhe u përfshi në një proces adaptimi, reformimi e zgjerimi të pa parë në 75 vite të ekzistencës së saj.

E kush nuk do ta dëshironte këtë eksperiencë, këtë mundësi për të qenë jo vetëm pjesë e këtij transformimi, por edhe kontribuues në këtë moment historik, Gjeneral ÇUNI, ushtaraku shqiptarë, djali i Shkodrës dhe Dukagjinit ishte aty, pjesë e tavolinës me 32 anëtarë të NATO-s, duke përfaqësuar me profesionalizëm, dinjitet dhe krenari Shqipërinë dhe FASH, ngjyrat Kuq e Zi.

Si vlerësim maksimal i punës dhe profesionalizmit për Gjeneral Çuni-n, lidhshipi ushtarak dhe Ministri i Mbrojtjes i rekomandojnë, propozojnë Presidentit të Republikës, Komandantit të Përgjithshëm të FARSH promovimin e Gjeneral Brigade Petrit ÇUNI në gradën madhore “Gjeneral Major”, me dekret nr. 24, datë 4. 2. 2025.



dhe performanca e shkëlqyer Gjeneral Çuni (atëherë Kolonel) emërohet në një

Çuni, përfaqësonte FARSH dhe ishte njëherazi dhe epror i drejtpërdrejtë për

Redaksia e gazetës, 12 shkurt 2025

▶ sot “Xhovani-4” shpk, fatmirësisht i njohur në të gjithë Shqipërinë dhe në rajon.

U rritem si firme më shumë vështirësi, në të gjitha anët.

Borxhe pa fund, për 25 vjet në banka dhe jashtë banke (ndjese të gjithë bankiereve që ju fsheha këtë të vërtetë), por edhe KISHA ta fal, kur është për të mirën e njerëzve.

Sot mbas 30 vitesh jemi me zero (0) borxhe të këqija (nga këto të zezat jashtë banke), por me borxhe në banke, të cilat maksimumi për pak vite mund ti shlyejmë, megjithëse bashkëpunimi me bankat është i domosdoshëm, fatmirësisht sot nuk na tremb ma as falimentimi, as konkurrenca, as e ardhmja e biznesit tone vijimësia që është kryesorja.

Është për ta tregu dhe mos ta majme sekret aspak, që mbas vitit 2015, kur ne u

rritmë dhe bëme një emër mjaft të mirë në treg e më gjere, u munduan të bëheshin pjesë e biznesit tonë persona të veshur me pushtet dhe që ishin pjesë e politikës, të futen në “XHOVANI – 4”, por megjithëse kishim plot nevoja financimi, asnjëherë dhe për asnjë arsye nuk ndodhi dhe as nuk mund të ndodh.

Gjate gjithë këtyre viteve ne, e njohëm vetëm Zotin, që e falënderojmë çdo dite, bankat që na besuan, 7 banka rresht na blemë te njëra – tjetra, na dhanë kredi plus dhe gjithë grupi i lartpërmendur, që bashkëpunuam në këtë udhëtim kaq të gjate.

Për 20 vite importe, duke i dhanë shtetit shqiptar disa miliona lekë dhe €, dogana, tatime, të gjitha detyrimet në bashki, komunë e sigurime shoqërore. E vetmja ndihme, në kohën e covid-19 ishte 1600 €, në një kohë, që shpenzimet ishin mbi 20 mijë

€, në muaj, por Zoti kishte mendua për ne dhe mbas një rënie jo të vogël filloj një malore e mirë.

Mbrapa u hap për ne drita jeshile dhe për dy tre vjet ecëm me hapa gjigande, me shitje të kleringjeve e njëkohësisht u hoqën të gjitha borxhet e këqija, që na shoqëruan për 25 vjet me radhe.

-Sot, ju them të gjithë bashkëpunëtorëve, e mbyllim me një shprehje të urte: “Zoti, në këtë bote i jep çdo njeriu atë që meriton!”

Faleminderit familja ime e mrekullueshme, bashkëshortja, vajza e dy djemtë, që më mirëkuptuat!

Faleminderit shumë të gjithë klientëve tanë, malësor, qytetar dhe nga të gjitha zonat për rreth, që na besuan, janë ato kryesisht që mundësuan rritjen tonë.

Faleminderit shumë të gjithë bashkëpunëtorëve, që punoni çdo ditë pa u

lodhur, dhe atyre që punuan, por nuk punojnë më për arsye të ndryshme!

Faleminderit të gjithë ato firma e kompani të fuqishme në Shqipëri dhe pronarëve, miqve tanë, që na besuan dhe shpesh na kredituan,

Faleminderit COOPERATIVA CERAMICA IMOLA DAL 1874, për 20 vjet bashkëpunim të shkëlqyer

Falënderojmë të gjitha bankat e nivelit të dytë, që na kredituan, ishin ushqimi kryesor gjate rritjes tone.

FALEMINDERIT O ZOT, KRISHTE, QË NA DHE JETËN, FAMILJEN DHE FATIN, PËR GJITHÇKA QË GËZOJMË SOT!

Viktor Arrinaj, të urojmë vetëm rritje në jetën tuaj, në kompaninë tuaj!

NDUE SANAJ

Thirrja ... bzâni Rrënjëve të mia në Kelmend

Ajo thirrje nuk ishte si të tjerat, ajo thirrje ishte ndryshe. Thirrje, e cila shkaktonte një ndjesi mistike, epiqendra e së cilës ishte në brendësinë time, e kërkonte ngulshëm të shkundte themelet e vetëdijes sime. Thirrje, e cila lindi porsì një vatrë drite, e rrezet e saj shtriheshin pambarmisht, e ledhatueshëm tentonin të preknin ngrohtësisht thellësinë e shpirtit tim...

... Ajo thirrje nuk ishte si të tjerat, ajo ishte ndryshe. Ishte një thirrje kokëfortë, kryeneçe, e palodhur. Me ngulmim kërkonte të dëgjohej, me ngulmim kërkonte përgjigje. Një thirrje shpërthyes si vullkani, llava e të cilit furishëm nuk kursehej të depërtonte në çdo qelizë të qënies sime. Dikur lindi thjeshtë si një psherëtimë zemre, derisa u kthye në jehonë. Jehonë që porsì dallgët, përplasej pareshtur në muret e shpirtit tim, e kërkonte të depërtonte për ta zgjuar atë...

... Ajo thirrje nuk ishte si të tjerat. Ajo ishte një dëshirë. Një dëshirë, e cila kishte kohë që vërtitej në mendje, e etshëm kërkonte të bëhej realitet. Origjina e saj ishte atje, në tokën e të parëve, atje ku zanafilla e identitetit tim buron. Të paktën një herë në jetë, të isha atje, mes alpeve, mbështjellë nën petkun e malësore, e të përqafoja identitetin tim, koduar në ADN time, i cili prej shumë kohësh priste të aktivizohej në Kelmend...

Ishte fundjavë gushti, kur unë jetova "Përrallë në Kelmend", e shoqëruar nga më të dashurit e mi, e unë isha protagonista kryesore. Një udhëtim magjik, emocionues, deri diku surreal. Zgjimi në mëngjes, shkuarja në një shtëpi malësorësh, ku mua do të më vishej xhubleta solli një uragan ndjesish të papërtuara më parë.

Atë të dielë gushti unë vishja xhubletën e punuar dikur nga stërgjyshja ime, për gjyshen time. Në sytë e mi ajo xhubletë ishte shumë më shumë, se sa thjeshtë një veshje folklorike e punuar bukur, ajo ishte një kryevepër, gati gati hyjnore. Çdo detaj kompleks i saj ndërli dhej aq natyreshëm. Çdo fibër, çdo ngjyrë, çdo element, çdo simbol i saj i përngjate një notë, e cila krijonte simfoninë më të bukur, e që tingellonte aq ëmbël në veshët e zemrës e shpirtit tim.

Në sytë e mi ajo ishte një kryevepër, e cila fliste me madhësinë e saj. Një kryevepër, e cila në heshtje, por plot vetëbesim klithte hijeshi, elegancë, finesë, feminitet. Madhështia e saj, më shëmbëllente me madhësinë e alpeve, të cilat puthin retë, prekin qiellin, përqafohen nga rrezet e diellit, e mbulohen me pelerinën e dëborës. Mos ndoshta ato që e veshin xhubletën, pasqyrojnë pikërisht madhësinë e atyre alpeve? Në disa gojëdhëna thuhet se ishin zanat e maleve, ato të cilat i dhanë grave të malësisë dijëbërjen e xhubletës. Mos ndoshta të jetë kjo arsyeja, pse xhubleta përcjell atë energji me veti hipnotizuese? Mos vallë është magjia e misterit i zanave të maleve? E tek notoja në këto mendime,

ndjeja se si çdo atom i xhubletës, vibronte nën lëkurën time e depërtonte deri në skajet më të thella të shpirtit, derisa ne u lidhëm, e u bëmë një.

Xhubleta si një portal magjik mes dy dimensionesh, më lidhi me të parët e mi, në veçanti me linjën e grave të familjes sime. E unë në ato momente isha e vetëdijshme se, çdo fije e asaj xhublete, të cilën unë mbaja veshur, e cila kishte kaluar në gishtrinjë e asaj që e punoi, mbart një moment, një ndjesi, një kujtim, një situatë, një përjetim, një emocion ... Ajo xhubletë është dëshmitare e përditshmërisë dhe e mundit të tyre. Në sytë e mi xhubleta ishte shumë më shumë se sa thjeshtë një veshje folklorike, ajo ishte një ditari, ditari i asaj që e krijoi dhe asaj që e veshi. Ditari i stërgjyshes dhe gjyshes sime.

Ndërsa mbaja atë xhubletë veshur, nuk ndihesha vetëm, ishim ne, e jo vetëm ne të treja, por shumë të tjerë e të tjera para nesh. Unë mbaja në trup një enciklopedi, mbaja në trup histori, ndihesha hyjnore e zemra ime ishte plot, pasi ekzistenca ime mori një tjetër kuptim. Unë dhe xhubleta dëshmonim ekzistencën e atyre prej të cilëve unë pasoja. Ishte pikërisht ky momenti, kur unë, një malsore me xhubletë në Kelmend, ndjeja se thirrjet morën përgjigje.

Kurrë nuk do ta harroj atë të dielë gushti, kur unë për herë të parë veshja xhubletën e nuk doja më ta hiqja nga trupi. Kishin kaluar mbi 14 orë, por për mua koha nuk

ekzistonte, isha përhumbur nën efektin e asaj ndjesie prej së cilës nuk ngopesha. Për mua ishte një takim me të parët, një takim i cili nuk doja të mbaronte.

Xhubleta sfidonte frikshëm ligjet e fizikës, e dimensionit kohor mori tjetër kuptim. Me xhubletën veshur jetoja në të kaluarën dhe në të tashmen. Në të kaluarën e tyre dhe në të tashmen time. Ajo e kaluar, dikur e tashmja e të parëve, mori jetë në të tashmen time. Me kryeveprën e malësisë veshur, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e tyre, u bënë një, pasi ato jetonin në të tashmen time. Atë të dielë gushti unë kuptova se xhubleta është shumë më shumë se sa fibra, materie apo atome. Ajo mbart copëza jete, copëza shpirti, jo vetëm të atyre që e punuan, por edhe atyre që e kanë veshur, parë apo admiruar.

Unë mendoj se ekziston një pakt i heshtur, mes secilës vajzë apo grua që e vesh xhubletën. Ato i japin një copë shpirti, e në këmbim marrin shumë fuqi, gati gati të mbinatyrshme. Hijeshi, fisnikëri, pushtet, fuqi, siguri, gjallëri, respekt, dritë, madhështi, magji ... çdo grua, e cila e vesh xhubletën, e vulos duke i dhënë autografin e saj, e një ndër to pata fatin të isha edhe unë.

Pas disa dekadash në gjumë letargjik, diku në një qoshe palosur, e mbledhur me kujdes, dashuri e nostalgji nga gjyshja ime, unë e zgjova atë, i dhashë një copëz nga shpirti, e ajo më dha shumë më shumë mua. E kur momenti erdhi, që unë të ndërrohesha e të vishja rrobat e përditshmërisë, ndihesha dikush tjetër, ndihesha ndryshe. Me rroba veshur, lakuriqësia pasuar nga rrënqethja dhe trishtimi më mbërthyen para pasqyres. Vetja më gjeti të papërgatitur përpara atyre ndjesive. E zënë ngushtë, u dorëzoja para tyre, e në atë moment ... u ndjeva bosh. A mos valle isha unë hirushja malesore? ...

E paharrueshme mbetet eksperiencia në Kelmend, gdhendur vetëdijshëm, e ruajtur plot dashuri e gjallëri, në sirtarin e ndër më të bukurave kujtime të mia. I paharrueshëm shkëlqimi që mori ekzistenca ime. Ndihej fisnike. Ndihej madhështore mbështjellë në atë kapsulë magjike. Isha unë, por edhe nuk isha unë. Isha unë, por nuk isha vetëm. Me mua ndjeja praninë e tyre, linjën e grave të familjes sime. Ndjeja mençurinë e tyre, eksperiencën jetësore, sfidat, fuqinë, forcën, guximin, trimërinë e tyre. Përjetoja ndjesi elektrizuese, të cilat furishëm vibronin fuqishëm. Isha unë, por edhe nuk isha unë ... Isha unë, por nuk isha vetëm ... në Kelmend ishim ne ... ishim ne dhe ajo ... ajo që na bashkonte ... Kryevepra e Malësisë ... XHUBLETA ...



Jetëshkrim i shkurtër për P. Justin Rrota

(BIOGRAFI, NGA P. DONAT KURTI, SHKODËR – DHETUER 1964)

Me 17 shkurt 2025, Padër Justin Rrota, "feston" në Amshim, 136 vjetorin e lindjes, që e bëri të pavdekshëm.

Padër Justini (Ndoci) kje i treti fëmijë nder gjashtë (katër vëllazën e dy motra), që leu me 17 Fruer 1889 në Shkodër, prej Gjushit të Gjon Qerraxhis (Rrota) e prej Shaqes së Jak Vjerdhës. Kje pagëzue me 18 Fruer prej D. Ndoc Nikaj e i kje ngjitë emni Ndoc.

Fill mbas azilit, që pat bâ te Tina e Nikës në Serreq, u shkrua në Shkollën Françeskane, ku kreu pesë klasë filllore e një klasë qytetze. Mundit e kujdesit të mësuesve të vet u përgjegji me sjellje t'urtë e me zëll nder mësim. I butë per natyrë, nuk përzihej aq fort me shokë per lojë e për argëtime. Rruga e tij e perditëshme ishte shtëpi e shkollë. Tuj i pasë prindët fetarë e të ndershëm, diftohej mjaft i terhjekun kah jeta françeskane, e tuj vijue me ketë dëshirë, u vu jashta orëve të mësimit me mësue gjuhen latinishte prej katekistit të atëheshëm të shkollës, P. Pal Çurçisë.

Me 28 Gusht 1902 hini në Kolegjen Françeskane të Gjuhadorit, pat mjeshtër P. Françesk Melchiorin.

Me 28 Gusht 1904 veshi zhgunin në Rrubig porsu rishtar nëper duart e Komisarit të Misjonit, P. Anastaz Vinçenzonin, me 29 Gusht 1905 iu kushtue Zotit me kushte të thjeshta, tuj marrë emnin Justin; mandej kje çue në Troshan, kû kreu kursin e filozofis, tuj pasë per profesor P. Pal Dodaj. – Me 13 Marc 1909 bâni kushtet e perhershme nder duer të P. Bernardin Shllakut, në Kishën e Gëjuhadorit.

Në Gusht të vjetit 1907 kje çue n'Austri në Vilak të Karincjes per këndime të Teologjis, por për mungesë shëndetjet, kje ngushtue me kthye në Shqypni një vjetë mbrapa (1908), e kështu kursin e teologjis e kreu në Shkoder e në Rrubig, tuj pasë porsu profesor P. Gjergj Fishten e P. Zef Lochmann-in, e P. Ambroz Marlaskaj.

I pregaditun me dituni e me shtrëngesë rregulltare, kje shugurue meshtar, e Meshen e parë e tha në Kishën e Gëjuhadorit, me 11gusht 1911; predkun e rasës e pat mbajtë P. Gjergj Fishta.


Dihet mirë, se çfarë ndrrimesh me randsi kjën bâ në Shkollën Françeskane porsâ e muer drejtimin P. Gjergj Fishta.

Prandej Justini, porsa kreu këndimet e nalta, u gjet i gatshe per me dhanë mësimin e gëjuhës amtare e kje shënjuie pà tjetër porsu profesor nder klasët qytetze të Shkollës Françeskane.

Se sâ me kujdes e me zotsi e kreu ket detyrë, e diftojn xansat e tij t'atëhershëm, si dhe programi i zhvilluem n'at kohë, kur gëjuha shqype nuk ishte ende e zhvilueme, as nuk kishte teksta per gramatikë e per sintaks. Kje P. Justini, qi me durimin e një dhënsi u vû me i rrahë me shkrim çashtjet e ndryshme gramatikore e me i zhvillue me sistem. Kjo punë vijoi deri ne vjetin 1917, kur, tuj kenë kohë luftet,

tuj mos mujtë me vijue shkolla në mënyrë të rregult, kje çue në Plan porsu famullitar e ndëi dý vjet aty, pá e ndalë vrullin në punë. N'aq pak kohë hapi shkollen e parë per fëmijë të katundit, e u hini në shpirt per dashtni e per dije e urti të mëdhajve e të vogjelve.

Në Shtatuer të vjetit 1919 kje çue në Troshan porsu profesor i gëjuhës shqype



e i latinishtes në Kolegjen Françeskane. Në të përpjekun me Vëllazent e tjerë të Provincës u diftue i gatëshem per me hapë një gimnaz publik në Shkodër. E njëmend, kûr në vjetin 1921 në mjes të një entuzjazmi të madh u hap Gimnazi Françeskan në Shkoder, P. Justini mbajti per vjet e vjet me nderë e me zotsi orët e gëjuhës shqype e të latinishtes nder këlasët e nalta e i dha veprimtarin e vet gëjuhsore, Shkollës auktoritet e nderë ...

Por P. Justini nuk mund të mendohet vetem gramatolog e shkrimtar i shkëputun prej idealit, qi ndoq e per te cilin u flijue. Ideali i tij kje françeskan: ideal punet, misjonit e shejtnijet per vedi e per të tjerë.....

Sikurse kje i pasun nder shkrime të veta fetare e morale, njashtu edhe kje i papritueshem nder konferenca e nder predke ... Ai ka kenë shembull punet e dijte me e shfrytze kohen mâ së mirit. Megjithse i smútë e me moshë të shtýme, ai punoi deri një javë përpara se me deké.

Nder ditët e mbrame njëni prej Vëllazenve per me i dhanë zemer i tha: "Ke arsye me e bekue makinën daktiografike, qi të shoqnoi në jetë e të siguroi Shelbimin". Ai u pergjegji: "Ajo më ka bâ me e perdorue kohën mirë".

Nji gjysë oret mbas mjesnatet të ditës 21 Dhuetuer 1964, ne e hâne, u dá këso jete P. Justin Rrota, tuj pasë te kryet shoqin e vet, P. David Pepën. Diq në Kuvend t'Arrës së Madhe.

Porsâ pushoj shkrimtari, pushoi edhe makina.

Kjo ishte një pjesë, çfarë ka shkruar P. Donat Kurti, në kujtim.

Për të, janë shkruar monografi dhe shkrime të tjera, përveç Kolanës së ve-

Kastratit: "Më nevojiten fort të kem ndonjë kopje të "Rreth Votrës". Njenën due me i a çue vëllaut në Vjenë. Më kanë thanë, se Jup K. e ka mundsin. E vërtetë? – ta kesh parasysh, Partia, ndë ato ditt e para, mâ dha me të shkrueme lejen të këndohen e të përhapen. Së besoj se të komprometoj me ka [...].

Ja, pra, ky Padër Justini, siç u shkrua mâ sipër, "kje çue në Plan porsu famullitar e ndëi dý vjet aty, pá e ndalë vrullin në punë. N'aq pak kohë hapi shkollen e parë per fëmijë të katundit, e u hini në shpirt per dashtni e per dije e urti të mëdhajve e të vogjelve".

Te, "Rreth Votrës" ai shfaqet me – Novela, Romanca, Kalxime, Legjenda –

"Ke del Kiri"

(Nga Kujtimet e mija)

Aso here, kur ma së parit më rá me e pa katundin Plan, të Malsis së Dukagjinit, paçë kenë përnjimend i terhjekun prej bukuris idylke t'asaj lugine së madhnueshme, rrethue prej malesh vigane, qi i bájshin aq hijshëm kunorë.

Blerimi i atij shpati, të cilit i vesheshin shpija e kësolla të mblëueme, ku me shpel' pishet, ku me kashtë theknet, shumica me rrasa e të vendueme aty - këtu pa symetri, gati të gjitha kundruell diellit të mjesditës; ky blerim qi hapej deri për gjysë të malevet, në rranxën e të cilave shtrihej vendi i banuem, mbaronte në fund të lugut, ku rriedhte i vogël, por i turrëshëm, pa ligjë, nëpër curra të zgavrruemë, lumi i Kirit.

Ishte nata e Shëna Ndout,

13 qërshuer 1919

Kumbonët e mbrames kishin thye për një grimë herë atë heshtimdekete, qi mbret-nonte për rreth. Njimend se kjo nuk ishte festa qi lutej me miq; ajo zyrtarja e famullis ishte me 17 kallënduer; por prap, edhe kjo lutej familjarisht, e kush kishte me se, e prente një kambë berrit, sa me gazmue robët e shpis.

Unë, si famullitar i ri, n'atë muzg të mbrames, ndërsa vrojshem me vemende bagtin tue u kthye kah shpija, e kah ndreqeshin me darkë se e cila n'atë mënyren e vet: lopa, me krye më kusi të krundevet tue u mjelë, thit e dirqët, tue ngranë si të dishruemë gjellën në govadë, pulat tue grabitë kokrrat e kollomoqit, qi shërbtori u hiedhte me grushta; ndërsa, mbassi shkuen në pushim të vet këto shtasë shpijake – gjurmët e lehta të njij kali qi drejtoheshin kah qela, m'i tërhoqën sýt andej kah rruga e madhe, qi vinte mbas kishet.

Mbi një mushk të përvútë, mbret besnik e trim i shkreparet, shoh se ishte tue ardhë vetë Shkëlqesa e Tij, Ipeshkëvi i di-oçezit. Ngava me i dalë para e me i marrë doren me gëzim; pse gëzim vertë i madh ishte për mue, e nderim i posaçëm ishte për famullit t'ardhunt e Ordinarit n'atë natë të madhe. Duka e tij ne e nesret në Meshë, në të cilën do të mbante n'ja dý fjalë baritore, do të bante, ishëm i sigurët, përshtypje të këthellë ndër zemrat e të gjithve.

Meshtari i malevet, dalë prej jete së këndimevet, dá shokësh, e largue prej ambjentit intelektualësh së qytetit, kur vjen sidomos së parit në një vend, ku s'ndien e s'shef tjetër, veç punët e çashtjet e njij jete

Ndërsa, P. Justini në letrën e datës 3/5/1958, ndërmjet të tjerave i shkruan

faret trashamane, qi s'përkon kurrkund me edukatën e tij; famullitari në këtë atmosferë krejt të ndryshme pëson çase fort të mërzitshme. I vetmi argtim, e vetmja habi për të asht njajo bibliotekë e vogël, qi ka mundun me marrë me veti. E mandej ka fatin me u pjekë më një shoq a nier shkollat, atje nalt, ndër ato vetmi malesh, i qeshet fëtyra e gëzohet, se i bjen t'at thejë një herë monotonin e asaj jete aq landore qi e rrethon; e me të cilën volens nolens i duehet me u marrë për detyrë të zyres.

E ardhëmja e Ipeshkëvit n'atë natë ishte për mue një gëzim pra, për imend i madh, e aq ma i madh, sa ma pak e pritshem.

U njitëm nalt, kinse nodë të miqvet. Ishim në valë të kuvendit, kur një zâ prej oborrit na e këputi fjalën.

- I bekue, o i bekue, a po del një herë deri poshtë!

Por unë gjithënjë, e sidomos në zâ mund t'at dave se kush ishte: Vojvoda I kryelagjës vetë i dyti.

Me lëjen e mikut të Ndershëm u ula n'oborr; m'a ndiente zemra se dishka me randsi do t'ishte. Pa i lanë me shkue gjatë, mejherë dojshëm me e dijtë shkakun e ardhjes n'atë kohë.

- Zotni, t'u rritët pushtedja, - m'a pret vojvoda - s'asht gjâ e keqe. Të kemi rá me na u bâ shoq në një punë të mirë. Sonte kemi dá me i a mësy Pjetër M. Në Gjuraj, a na e falë atë gjak qi din.

- Mirë fort; por shi sonte në ket natë Mandej, a s'e keni marrë vesht se kam mik Zotni Ipeshkëvin? Më vjen e vështirë me e lanë vetëm; s'ka hijë. A ban me e lanë këtë punë për nesër mbrama?

- Lum Zotnija, njiketë natë të madhe, - na ndihmoftë! - e kemi ruejtë me i rá Pjetrit, kesh po na e falë për hatër të qirit të festës. Kështu e kemi na zakon gjithmonë, kur duem me pajtue robnin. Sa për punë të Zotni Ipeshkëvit, mos u mërzi aspak. Na ju fal me shëndet Zotnisë, na i ban nderë me shka të ka fal Zoti, se puna pret. Na kemi me ardhë me të marrë njaty afër mjesnatet, e mandej...si t'at bâjë Zoti Tash, të mirë u pafshim e me zemrë të mirë!

- Me gjithë jú bashkë, e udha e mbarë!

U ktheva nalt tu Imzoti, qi më pritte për me dijtë shka ishte zani. Kur i diftova për shka më kishin thirrë, Ipeshkëvi më dha zemrë me i a hi pa pritesë asaj vepre së mirë.

Si nier i rraun ndër këso rasash shtoi edhe disa këshille e mësim praktikë, për t'i dalë në krye punës ma me siguri. Më kallxoi fakte analogje, qi i kishte pasë sprouue dikur ai vetë

U shmanga nodë teme. Nuk rash; pse mendët i kishem gjithënjë tu manovra, tu rezultati i së mësymes, qi më pritte atë natë. Me një libër çilë mbi tavolinë, rrijshtëm tue pritë se kur po më bajshin zâ....

Shof se bashkë ma ata dy qi kishin ardhë me më bâ zâ herën e parë, ishin edhe n'at dy a tre tjerë, të gjithë miqë e kumbarë të shpis qi ishim tue mësy. Më thán me shkue e me marrë një kryq të madh qi kishem m'eltherë e qi do t'ishte i nevojshem për çeremonin tonë.


U nisëm, pa zâ, nëpër ato rruga të ngushta të katundit....Hana, në të katërtin e mbramë, njatë herë porsa kishte shkrepë rrezet mbi majat qi kishim për bâll. Nuk

ndiehej tjetër për rreth lagjevet ku kaloshim, veç ndonji qen tue lehë më në, a... më hanë.

Si râm në fund t'asaj teposhtje, s'kishim veç edhe 10 minuta, për me u kapë tu shpija e synueme. Na thán me xanë vend; edhe u ulëm ndër shkamij gjatë rrugës. Ma i moçmi i komitivës, Mar' Prël Vata, në kambë e tue u pështetë për shkop, nisi me na mësue, se të cilin atë pjesën e vet, qi do tfaqshim n'atë shenë dramatike...E pikë së parit, tue u sjellë prej meje, më tha: -Ti, Zotni-a, kur t'ap shëjin vetë, pa fjalë ke për të marrë kryqin e me e vù mbi stol, mbulue me rubë, por këqyr me e vù përmbys e jo mbarë.

T'jervet nuk pat nevojë me u fol gjatë, si gjinde e mësue me qi ishin ndër këso rasash.

Fjalët e plakut aty mjedis rrugës, n'atë vetmi, në pikë të mjesnatës, tinglloshin



madhnueshëm, si fjalët e njëj Katoni në Senat. Unë rrijshtëm si një xanës tue ndigjue me vemende lekcjonin, qi më jepte plaku ... Prej së mbrendit ma së parit na e lëshuen një zâ : O, shka jê ti more, tash natëm!

- O, s'a gjâ more; por, a doni miqë? ... i gjegji zanit njeni nesh.

Si na shikjue një herë nëpër bira të frengijjavet, për m'u sigurie, na duelën para n'at dy ashtu veshë e njeshë, një tjetër zdrypi vrap n'oborr me na i pritë qejt e me i qetsue pak, se kishin marrë tepër zemrë më ne.

Na muerën dorën e na prin mbrendë Ndezën zjarmin menjherë, na poqen kafe, ndërsa miqsija e ata të shpis shkoshin tue i a hjedhë shoqi - shoqit kush kutijat, kush qeset e dyhanit.

Në një shëj kohet ai ma i moçmi më bani me krye, se ishte çasi me i a fillue. Meni me një herë fjala sa më pán mue se xora keyqin e e vendova, me fëtyrë përmbys, mbi stol të shtruem me façoletë.

Atë herë edhe ndrikulla zgjidhi fëmijën e e muer ngrykë, rrokullisi djepin e e vendosi para vetit për së mbrapështit.

Tjerët, qi kishin ma e shumta Shgjon e kumbari me të shpis, u çuen njazit gati si në gjúy e mëdhaj, lidhun me duerë për mbrapa, para vllaut të të vramit.

Mue më përkitte, si Meshtar, me folë ma i pari:

Or Pjetër, na e falni mërzin, qi ju kemi dhanë sante. Për hatër të Zotit e të kësaj

nate së madhe, ju kemi rá me na falë. Kthena mbarë këtë krygje shëjte; na e siell djepin e famullit....

Si mbaruem, ndëjen të gjithë pa zâ. Pritshim fjalën e të zot' të shpis.

- Or burra, - tha Pjetri - na keni xanë pakë si ngusht sonte. Por po dalim njherë m' anesh e mandej shofim, palë si po i a bâjm ...

Ishte një akt njimend heroik, qi kërkoshim sish. Gjaksi, për të cilin kishim hi ndërmjetës, kishte pasë punue tepër mbrapshhtë.

Ishte vjeti i ús qi përmendëm. Gjindja ishin bâ si hije deket, i siellshin malit e fushës për barishte, rrâjça e këlkaza, sa me mbajtë gjallë frymën. Një natë për terr një shoq i Pjetrit, i afërm me shpi e ndoshta fort ma i afërm me gjak, viedhet tinzisht e

e pajtue këtë shoq. Edhe na për hatër të kësaj nate së madhe e të Shëjtit Sh. Gjon, qi kemi ndër veti, e kemi pleqnue me ju a fâlë, e mos me i ra ma mbrapa kësaj pune.

Kështu foli Pjetri, e ndërsa flitte, i dridheshin buzët e krejt shtati. Muer krygjën prej stolit, e puthi, e vuni në bâll edhe e suell mbarë. Ktheu për së mbarit edhe djepin e famullit, e shkoi e xuni stolin e vet. Por ma para i u avit gjaksit, i a zgjidhi duerët; e muer ngrykë e: "Po të fali - i tha - e po të bâj vllá. Hallall të kjoftë!"

Unë e pásh, kah, tue thanë kështu i pështuen burrit të dheut dý cirka lotë. Kushrinija e tjerët rob' ndërkaq rrijshtin pa zâ me krye për dhë.

"Edhe ju faqebardhë kjoshi, - u a pritëm na të gjithë njëj goje - qi na e këqyrët hatrin. Falemi nderës njëqind e njimijë herë prej jush! Zoti ju ruejtët me gjithëshka keni, e gjá e keqe kurr mos ju gjetët!"

Si kjën rreshtue të gjithë ndër stola e trupica, ai ma plaku xuer qesen e zhyeme të duhanit e i a hodh ma parë të zot' të shpis e mandej tjeret rrethas.

Ndërkaq u vù xhezja në zjarm, për me na pjekë edhe kah një kafe ...

Gëzimi u shifej të gjithve në fëtyrë; por ma të madhin e diftonte gjaksi i zgjidhun, të cilin e kishin vù tash me ndëje në krye të vendit.

Unë këqyra sahatin: Kishte kalue 1 mbas mjesnatet. Njinesa e Meshës kishte fillue kaherë për mue, e s'kishem si rrijshtëm ma gjatë. Mora me veti njenin pleqësh, e u drodha kah qela, tue i lanë tjerët me e vijue kuvendin, qi kishte marrë në një tjetër krah.

Dikur populli u shperndá; dikur shkoi edhe Ipeshkëvi. Mbeçë vetëm, e n'atë vetmi rásh në mendime:

"A thue gjithmonë ky popull i shkretë do të mbesi kështu, me i u dhimbtë gurit e drunit? ... Nuk e meriton ... Asht mjaft bujâr e burrë. Sod auktoriteti e friga e ndeshkimit i a kanë pengue guximi e nuk vriten si përpara; por në zemrë të vet këta, e dij hollë, bluejn mëni e ahmarrje ndoshta edhe ma të zeza se perparandej, e rrijn tue pritë rasën me e bâ të vetën!

Nuk ásh, jo, forca ma i pari e i vetmi mjet, për me e zbutë zemrën e malësorit. Shkolla, rrugat, të përpjekunat, përmirësimi i gjëjes jetsore, shërbimi ushtark, qe mjetet, qi do të kët para sýsh qeverrija e gjithkush dishron të mirën e vertetë të tij. Fuqija ásh një mjet tepër i dhunëshëm për të, e pengon, por nuk e then nuk e ban nier, nënshtetas të vjefshëm për veti e për komb!"

Fundi i shkrimit, dedikuar P. Justin Rrota, sot me, 17 Shkurt 2025, në 136 vjetorin e lindjes së tij.

Libra të përdorur për shkrimim:

*Át' Justin Rrota O.F.M "DITËT E MBRAMËT TË TURQISË NË SHKODËR" ASE RRETHIMI I QYTETIT (1912-1913) Botimi i II, Át' Justin Rrota O.F.M "RRETH VOTRËS" Bleni I, Bot. II "EPISTULAR " Prof. Jup Kastri - P. Justin Rrota O.F.M 1951 - 1964.

Nga LEONARD QYETEZA

I vllau i të vramit, qi kishte dalë nodën tjetër, për me pleqnue bashkë me të kushrijt, se çë të gjegjun me na dredhë, dikur ktheu. Na të gjithë m'atë herë bâm braf mbë kambë për nderim. Pa tjetër i zoti i shpis i a nisi:

- Faqebardhë kjoshi të gjithë, ti Zotni e Ju miqë e kumbarë, qi keni ardhë me

Gentjan Gropa - Zëambë dhe duararti i Folklorit Dukagjinas

*Kur më t'vesin prej ka jam
Në gjak e në fis unë jam Shaljan
Me tradita prej florinit
Heeej jam Thethjan prej Dukagjinit*

Sa kandshëm tingëllojnë këto vargje të kësaj kënge e cila këndohet nga këngëtari i talentuar Gentjan Gropa.

Sa bukur dhe mirë kur një djalë i ri këndon me plot hare për origjinën e tij. Me ballin lartë e me fjalë që burojnë nga zemra, ai e veshë këngën me plot gjallëri e krenari.

Ai respekton fisin, e fillon këngën në prag të Kishës së Thethit. Pastaj ndalet tek memoriali i Shtatë Shaljanëve e vazhdon duke sjell imazhe nga zemra e Shalës të cilat shpalosin bukuritë e kësaj natyre. Kjo tregon se Gentjani është artist i lindur dhe i pasuruar me vlera shpirtërore si ku ma mire se sa në trollin e Lul Gjokës së Gjelajve të Thethit. Familje patriotike, nderi e bujaria kanë qënë frymëmarrja e përherëshme e këtij trualli që ka nderuar vetën dhe Dukagjinin përgjatë gjithë historisë.

Duke menduar jetën dhe veprën e shumë artistëve Dukagjinas tek të gjithë shohim themelet ku janë rritur dhe edukuar, gjë që i ka ndihmuar të jenë njerëz të mirë, të rrespektuar dhe artistë të parritshëm dhe veprën e tyre.

Tek dëgjoj dhe shikoj Gentjanin në interpretimet e tij dhe suksesin e deritanishëm me plot bindje theksoj se ai është brumosur si njëri i mirë dhe me vlera të cilat e ndihmojnë për të ecur përpara. Ka disa vite që Gentjani është pjesë e kreative e Folklorit Dukagjinas duke e përfaqësuar denjësisht në skenat e vendit por edhe të Evropës.



Krahas të kënduarit Gentjanin e shikojmë dhe si një instrumentist, për moshën e re që ka shumë të talentuar në çifteli dhe sharki, gjë që e ka bërë të domosdoshëm edhe në intreptrimet e këngëtarëve të tjerë. Bashkëpunim të cilin Gentjani ju dhuron gjithëmon bashkëpunorëve me çiltërsi dhe pa interes, vetëm me dëshirën e mirë që të gjithë të siellin floklor të mirë dhe interpretime të suksesshme. Në çdo intrpretim Genjanin e shikojmë të qeshur e cila ja shton edhe më shumë hijeshin që i ka dhuruar Zoti. E qeshura e tij shoqëron çdo tingull të këngës dhe e bënë atë me

të pëlqyeshmë për shikuesin. Dua të përmend disa bashkëpunime të sukseshme si:

-Përmendoret e historisë:- Dukagjin për ty po këndoj:- me Bledar Hysenaj

-Kolazh- Moj belholla shtatselvi:- me Viola Shqau dhe Noel Pjetri

-Kush guxon e fiton - me Luiza Reka

-Nuk ta bjen dashnin unaza- me Bledar Hysenaj, Emanuela Neçaj, Mirela Brush-tulli.

Në shumë biseda me Gentjanin kam dëgjuar vetëm dëshirën e mirë të tij, që çdo këngë e këngëtarëve të tjerë të ketë sukses dhe vleron punën e tyre. Nga kjo e

kupton vlerën e të qenurit artistë në shpirt dhe të qenurit njeri i mirë. Sa nevoj ka jetë sot për të rinjë si Gentjani që punojnë për vetë, bashkëpunojnë me të tjerët dhe shikojnë përparë për të realizuar interpretime sa më të arrira. Gentjani është pasqyra më e mirë e familjes dukagjinase e cila rrit dhe edukon njeriun e mirë dhe me vlera. Ai është falenderues ndaj Zotit që e fali dhe prindërve që rriten dhe edukuan, në veçanti nënës që i ka kushtuar dhe këngë.- "Vetem Nanë nuk t'bahet kush"

Në Shoqatën Atdhetare Dukagjini, ai është antarë i kryesisë së Shoqatës, ku ju ka besuar seksioni i të rinjëve. Ai punon shumë për afrimin e të rinjëve dhe së bashku me Violën punojnë në realizimin e aktiviteteve muzikore të Shoqatës.

Gentjani me të drejtë thotë: - Në gjak e në fis unë jam Shaljan- sepse ai e ndjen vetën djalë të denjë e gjakëpastër i fisit të Shalës.

Me tradita prej florinit- traditat për Gentjanin janë flori që nuk i ndryshk koha dhe nuk i përdhos toka. Në shpirtin e tij ai i ruan traditat dhe vlerat njerzore, ashtu siç ja kanë trashiguar prindërit dhe të parët e tij. Sa bukur tingllon jehona e kësaj stafete që tani po e mbanë fortë në duar Gentjani: - Heeej jam Thethjan prej Dukagjinit

Gentjan! Ne të urojmë të këndoftë zemra dhe jemi krenar për vlerat që ju i dhuroni familjes, Fisit të Shalës, Shoqatës, Folklorit dhe shoqërisë.

Të urojmë suksese.

ROZA PJETRI

Sabah Bizi: Karriera që Vijëzon Transformime Epokale në Sport e Shoqëri

Data 16 Janar 2025 ishte një ditë zie për Shkodren në veçanti por edhe për të gjithë sportin shqiptar në përgjithësi. Sabah Bizi, legjenda e topkëmbës u nda nga jeta dhe me vete mori përjetësi tekta Shkodrës i trashëgoi lavdi.

Unë personalisht i përkas një brezi të ri por duke qënë se futbollin e kam praktikuar për disa vite ndër të cilat më dhjetëra herë jam stërvitur pikërisht nga Sabah Bizi, duke shtuar këtu edhe posedimin e shumë informacioneve dhe materialeve rreth futbollit, mund të marr guximin në pak rreshta të përshkruaj Bizin teknikisht. Edicioni i sivjetshëm i Super Ligës përbën të 86-tin në historinë e kampionateve tona dhe nëse dikush më lëshon një sfidë për të filtruar 11-tshen më të mirë të kësaj historie futbollit, natyrshëm Sabah Bizi të vjen në mendje ndër të parët. Kjo ka të bëjë me shumëçka e më shumë se me tituj e dekorata, teknikisht ka të bëjë me talentin e lindur

dhe me novacionin që solli Bizi në futboll pikërisht në rolin e tij në fushë. Bizi ishte pika e kthesës së madhe nga një futboll i rrëmuar tek një mesfushë me ekuilibra dhe racionalizim të përpiktë, duke e rritur stekën e cilësisë në futboll më lartë se kurrë më parë. Për nga talenti natyra ishte treguar shumë bujare me të, duke i dhënë dhunti të gjithanshme. Sabahi ishte nga ato lojtarë që marrin ekipin mbi shpatulla për nga karakteri e grinta, por ishte edhe truri i lojës sa herë zbriste në

fushë. Në sajë të personalitetit ai arriti të bëhej edhe kapiten i Kombëtares e siç dinte vetëm ai, të fitonte zemrat e masës, duke fituar duele të famshme me Dejne, Prohaska por edhe vetë Bekenbauer. Bizi u shpall katër herë kampion kombëtar me Vllazninë e Partizanin, kampion Ballkani me Partizanin, por atë e veçojnë performanca që nuk do shuhen lehtë nga memoria kolektive e kombit tonë, sic janë duelet ndaj Gjermanisë në '67 e '71, Torinos, Austrias, etj. (Dizdari, 2019). Shembull i një disipline të pasqur në punë, Bizi i shërbeu nevojave të ekipit duke u përshtatur me çdo lloj roli në fushë, deri edhe portier në momente të veçanta.

Me një djalëri të përherëshme, tipike e karakterit të tij, Sabahi fitoi zemrat dhe rrespektin e çdo Shkodrani. Gjatë viteve të tranzicionit ai dha një kontribut të jashtëzakonshëm duke stërvitur brezat e rinjë. Kam patur fatin t'a shikoj nga



afër mënyrën e tij të punës dhe mund të them me plotë bindje se ai ishte i fundit edhe përse i përket një cilësie tjetër. Teksa punonte me fëmijë, sytë i shkëlqenin nga pasioni e i nxirrnin xixa nga grinta e nga dëshira e madhe që brezi i ardhshëm t'a përfaqësojë me dinjitet e dashuri të madhe fanelën e Vllaznisë. Ashtu siç nisi karriera e Sabahit, duke ridimensionalizuar teknikisht rolin e tij në fushë për të sjellë për herë të parë në Shqipëri mesfushorin modern, ndarja e tij nga jeta është po ashtu një kapërcim epokal. Në komercializimin e çdo aspekti të sportit sot, ndarja nga jeta e Sabahit, shënon fundin e kësaj grinte unike për Shkodër e për Vllazni. Pjesë e rendësishme e fabrikës sociale të Shkodrës gjatë një terri të gjithanshëm nga politika e kohës, Sabah Bizi do të jetë një etalon të cilit do të na nevojitet t'i referohemi shpesh.

FRANC SHKËMBI,

Vienë 27/1/2025

Referenca: Dizdari, B. (2019). Sabah Bizi ... dhe brezi i tij: dy dekada histori të futbollit shqiptar dhe gazetarisë rreth tij (1964-1982). Botimet Kujtimi.

Mbijetesa e Mark Sokolit në Amerikë dhe nostalgjia për Nikaj-Mërturin

*Pa mohuar eventet e planifikuara e të organizuara, ato spontanet shpesh herë kanë më shumë bukuri e emocione; edhe kjo që po shkruaj ishte një e papritur e këndëshme.

Një telefonatë e datës 15 nëntor 2024 nga shoku dhe miku im Ndoc Malaj, për një takim në ditën e nesërme, më zhyti e më ngjalli shumë kujtime të kaluara, të para më se 35 viteve. Motivi, si i thonë për kokërr të qeftit, për njerzillëk, pa asnjë interes a paragjykim.

Ajo tavolinë me 7 veta, secili më dinjitoz se tjetri, me thjeshtësi e qytetari, me vlera e kontribute që meritojnë vlerësim...

Siç e pata shkruar në statusin e parë në facebook, kur njeriu frymëzohet ashtu si pa e kuptuar, që ngjan me sinqeritetin e fëmijës, qershia mbi tortë që Mark Lulash Sokoli i Palçit, ish kolegu ynë, kur punuam si mësues në Shkollën e Mesme të Bashkuar Lekbibaj. Ndonëse nuk mund ta quaj mysfir, atij i takon respekti, duke u bërë edhe sebepi i takimit tonë (ashtu si rastësisht), pa shumë bujë e rrahje gjoksi siç bëjnë disa. Paskemi patur shumë nevojë për këtë 'kafe' e takim mes shokësh, me mallin që na ka krijuar ndarja e këtij Tranzicioni të dhimbshëm; të gjithë jemi më mirë, por të shpërndarë e disi të ftohur me njëri-tjetrin, pa arsye e pa ditur se çfarë të tregojmë a të justifikojmë.

Falë zhvillimeve të shkencës e mundësive që na ka krijuar teknologjia moderne e komunikimit, mund ta amortizojmë disi këtë handikap, por jo, fatkeqësisht jo; kjo dukuri është një lloj mjerimi shoqëror.

Marku, i ardhur nga Amerika, me shumë ngarkesa familjare e shoqërore, u kujtua të interesohet e të pyes për kolegët e punës e të na dhurojë me shumë dashamirësi ato çaste që do t'i kujtojmë gjatë.

Ndonëse në biseda të këndshme e relaksi, nuk harroi të interesohet deri në hollësi për shokë e miq të tjerë, me ta cilët ka ndarë gëzimet e hidhërimet, ka punuar me të gjitha forcat fizike e mendore, larg interesit material, për arsimimin e edukimin e brezit të ri, për një shoqëri më të emancipuar e të përparuar. As ai, as kolegët e tij, nuk mburren për përkushtimin e pashoq, madje rrinë modest në natyrën e tyre, kur dëgjojnë vetmburrje e vlerësime të pamerituara. Shpesh herë, me të drejtë, bëjmë vërejtje se na kanë harruar, pa u thelluar në hallet e vështirësive që ka gurbeti. Miku ynë u shqetësue se nuk mundëm të bashkoheshim të gjithë, ashtu si dikur, që u penguan nga largësia apo ndonjë pamundësi tjetër, ndonëse nuk munguan komunikimet nëpërmes telefonave.

Meritoi respekt e mirënjohje për kohën e vëmendjen që na kushtoi e respektin që tregoi; ne e çmuam shumë këtë sjellje të mbështetur në traditën e zonës, por edhe në normat e një edukate të mirë.

Aq shumë biseduam e u forcuan lidhjet shpirtërore, sa, kur u ndamë, mbetëm të etur, edhe më shumë, për takime të tjera.

Mua më ngjau si ai shiu i parë fund korrikut, që ka nevojë edhe për të tjerë, për të patur bereqete të mbara.

Secili në atë tavolinë e meriton një shkrim homazh, madje kanë një jetë aq të pasur e me kontribute të shquara, sa mund të shkruhej edhe një libër (Dhimitër Muslia, Zef Përpali, Frrok Vukaj, Mark Sokoli, Pjetër Halili, Pjetër Gjergji, Ndoc Malaj).

Shqiptari e në veçanti Malësia është e shquar për mikpritjen e respektin e mikut, ndonëse ky i sotmi është në trojet e veta;

miqësor, duke bërë këtë publikim, por këto arritje, desha t'i ndaj edhe me miqtë e shokët e tu, duke i renditur me ato të nikajmurtasve të tjerë, për të cilat gëzohemi e ndjehemi krenar.

Lart e më lart dy simbolet (flamurët) e dy kombeve, që valviten krenar në kullëntuaj, që mbart e trashëgon vlera pozitive nga trojet e përmendura të Palçit.

Gëzuar të gjithëve Festat e fundvitit e Mbarësi për Vitin 2025

* Duke cituar vetveten pak më sipër thashë me sinqeritet: "Unë e di se janë dashur shumë vite punë e sakrificë, kon-

polinë për ndryshimin e jetës, por për nga dramaciteti ngjajnë si udhëtimi mes Shillës e Karibdës (kur je midis dy rreziqeve të mëdha, kujto nga mitologjia greke-udhëtimin e Odisesë për Itakë).

I tillë ka qenë për Ju edhe viti 1995, kur morët atë vendim kurajoz e kur u paraqitët në Fieri, në brigjet e atij deti, sa i këndshëm në kohë vere, aq më problematik në kohë vjeshte e dimri. Thonë se të dënuarit me vdekje e presin disi me padurim ardhjen e orarit për ekzekutim...për t'u mbyllur një tmerr pa fund...

Edhe këtu më duket se ka një farë për-



pra, duke më mirëkuptuar edhe kolegët, sot po shkruaj për Markun e jetën e tij me plot peripeci.

* Një "shpërdorim" miqësor ndaj Mark Sokolit të Palçit (në Facebook)

I dashur Mark!

Sigurisht se ai takim i 15 Nëntorit 2024 me disa shokë e miq, u bë shkak për të rikujtuar vitet e gjatë të punës e për t'u njohur më nga afër me jetën personale e familjare të njëri-tjetrit në këto vite ndarjeje të dhimbshme.

U gëzova shumë e ndjeva kënaqësi për filmimin (videon) që më dërguat, për sukseset e arritjet tuaja në Amerikën e largët, duke më plotësuar në mënyrë konfidenciale edhe kërkesën time për sa më sipër; unë e di se janë dashur shumë vite punë e sakrificë, kontribute personale e familjare.

I gëzofshi arritjet e u ndjefshi lezetin me grue e fëmijë, me nipa e mbesa, sukseste të tjera, me mbarësi, shëndet e lumturi familjare.

Të kërkoj të falur "për këtë shpërdorim"

tribute personale e familjare".

Me sa kam parë konkretisht (e kuptuar), kur kam shetituar në Evropë, por edhe lexuar e dëgjuar për Amerikën, nëpërmes të afërmeve të mi, shokëve e miqëve të besuar, nuk ka qenë, as është shesh me lule emigracioni, as një shëtitje e mikpritje aq e ngrohtë sa e besojnë disa naivë, që shohin ëndrra në diell apo të tjerë "ekspert", që diskutojnë nëpër tavolina a në takime të organiaura me raste gëzimi a fatkeqësishtë.

Sa strese e dilema ka njeriu, që nuk mund të shprehën, kur merr një vendim për një ndërmarrje aq të guximshme e aventurë me rreziqe të mëdha, ndoshta edhe fatale; mishi po më bëhet kokërr, kur kujtoj histori të dhimshe mbijetese titanike, por edhe tragjedi që nuk harrohen. Aq pranë janë jeta e vdekja; këtu gjen vend shprehja popullore "njeriu e ka ma afër oxhelin se këmishën".

Gjithsekush ka vite të veçanta, që shenojnë kthesa të mëdha, që janë tam-

çasje e paralelizmi. Një torturë e vërtetë orët e ditët e pritjes...4 hërë jeni nisur e po kaq herë jeni kthyer përseri në breg për arsye sigurie, moti të keq a enigma të tjera që nuk dihen.

E treta e vërteta thotë populli, por vërtetë herën e pestë u realizua kjo nisje dramatike e 2 dhjetorit 1995 e shoqëruar me gjithëfarë emocionesh, që nuk mund t'i thotë saktë asnjë psikolog.

Në një det të trazuar në maksimum, që nuk përshkruhet për nga vështirësitë e problematikën, 7 orë rrugë me gomone, janë një torturë e vërtetë, një tmerr që nuk ka të mbaruar, me një përfundim të paditur...

Një ditë e tillë do të mbetet e paharruar në mendjen e çdo njeriu normal, ndonëse Marku, për fizikun e karakterin e fortë, nuk e ndjen aq shumë tronditjen..., por ka ndjerë rraskapitjen dërmuese, kur ka zbritur në brigjet e Kalabrisë. Për çdo njeri, sado trup fortë e i kalitur, kjo aventurë do të donte kohë për

◀ të rigjeneruar energjitë e shpenzuara e marrë vehten emocionalisht, se, jo radhë, kanë ndodhur edhe gjymtime fizike e trauma psiqike.

Sikur të mos mjaftonte kjo, edhe një sprovë fundore për jetë a vdekje, rreth 200 metër në ujën pothuajse akull, për të arritur bregun e detit. “Nuk di se si, por si i thonë, gjallë a vdekë kemi mbërrit në breg; asnjëri, pothuajse nuk mund të fliste asnjë fjalë. Po të kishte zgatur edhe disa minuta udhëtimi, mendoj se askush nuk do të dilte i gjallë në breg të detit etj.etj” - një pohim që të rënqeth trupin e të le pa fjalë...

Populli thotë: “Më mirë një mik i mirë, se një çiflik” - Fran Vukaj në pritje e për gjithçka duhej, me përkushtimin e përkujdesjen më të madhe.

“Një vit pune hamalleku e shumë mëzri dhe një dorë pare, ishte rezultati për një vit kalendarik në Itali.

Gjithnjë kam patur ambicie për biznes e kjo ka qenë edhe arsyeja që nuk pranova ofertën për mësues tek shkolla “Ahmet Gashi”, në Laprake, e afruar nga organet e arsimit në Tiranë.

Pas kthimit tim nga Italia, kemi hapur një dyqan ushqimor dhe një lokal të vogël, ku kem punue si familje deri në largimin për në USA.

Gjatë këtyre viteve, patjetër, herë pas here, kam bërë punë të ndryshme si punëtor e mjeshtri: (saldim, mure, suvatim, pllaka, armatura, etj).” - tregon Marku me sinqeritet.

Në kërkim të një jete më të mirë e të një përvoje të re, nga gjysma e vitit 2002 deri në gjysmën e vitit 2007, ka punuar si instruktor në Autoskollën “PALNIKAJ”, një kohë mjaft rezutive, ku shprehë mirënjohje e respekt për pronarët e saj, z.Mark dhe znj.Prenda Palnikaj.

...Në një moment të caktuar, kur rrjedha e bisedës po bëhej interesante, vërej se diçka nuk po shkonte mirë; ai filloi të zbehej, të fliste si i mekur e diçka po i mblidhej lëmsh në fyt...Ruajna zot thashë me vehte, ç'po bëhet, se këto vitet e fundit ai i mallkuari Covid-2019-ka lënë shumë pasoja, megjithëse, me sa e dija, Marku gëzonte shëndet të plotë. Kur unë kapa fillin e mendimit, vërej se po fliste për dy tragjedi familjare...

“Pa dyshim se ngjarja më e trishtë në jetën time ishte humbja e vëllait të madh, Gjonit, prej të cilit gjithë familja jonë, vëllezër e motra, ndjemë dorën e ngrohtë e përkujdesjen e vazhdueshme. Ai ka luajtur rolin e babait, i cili ndërroi jetë, kur unë isha vetëm 9 vjeç.

Gjoni ishte shumë i zgjuar, i ndershëm, bujar i madh, i matur e fliste avash, por e gdhente fjalën, pa rënduar askënd, respektues e i thjeshtë, sakrifikonte e bënte më shumë se i kishte mundësitë etj. Iku në moshën më të mirë, kur i kishte gjitha mundësitë për të shijuar jetën... Si me kujdes, gjej rastin për të ndërruar bisedë, që Marku mos të rëndohej emocionalisht... Ndërsa po fliste me fjalë zemre e shumë ndjenjë, unë kujtoja Gjoni fisnik, për të cilin mund të shtojmë edhe shumë cilësi të tjera pozitive të merituar, por edhe

bashkëbiseduesi im po lartësohej para meje me ato vlerësime, që bënte për të ndjerin vëlla. Shumë vlera kemi, por kemi edhe anti vlera e një ndër to është mosmirënjohja...Njeriu, si qenie shoqërore, është shumë i përsosor, por në disa skuta të errëta ka edhe ca hije të zeza, që e zvogëlojnë shumë...që po manifestohen shumë në vitet e fundit...

Për vetë pozicionin e punës që kam patur e vitet e gjata të jetës në Nikaj-Mërtur, përgjithësisht më ka rastisë të njoh shumë njerëz.

Nga këto biseda e të tjera të mëhershme e të më vona, duke veçuar e mos harruar edhe Antonin familjarisht, që e njoh prej vitesh, më rezulton se familja e madhe e Lulash Gjonit ka trashëguar e ruajtur me nder traditat pozitive të truallit e të krahi-



nës, në themel të të cilave qëndron puna, ndershmëria e harmonia-një bazë e shëndoshë për arritje e suksese.

...Me Markun, ndonëse kanë kaluar mbi 35 vite, që nuk kemi punuar bashkë, i kemi ruajtur lidhjet, madje jemi takuar në Tiranë edhe pas ikjes në Amerikë.

...Po kam dëshirë ta sjellë ndërmend, kur erdhi si mësues agronom në Shkollën e Mesme e vitet që punoi aty; sigurisht se shumë gjëra sot i shohim më me objektivitet, por unë po flasë me përshtypjet e gjykimet e asaj kohe. Personalisht nuk mund të them, se, paraprakisht, kisha ndonjë njohje të thellë, madje, mbase nuk e dija se i ati ishte ndarë nga kjo jetë (unë në atë kohë kam qenë nxënës në pedagogjike). Si ish drejtor, edhe për disa kohë ndoshta nuk e mora vesh...Kjo një vlerë shumë pozitive, se, ai nuk donte me spekulue as me u viktimizue si halexhi e jetim...Di raste që edhe pas shumë vitesh martese quhen e justifikohen si jetima...

Ashtu siç na kujtohen rastet negative, shembujt pozitiv e njeriu i vlerave, mbahet mend për virtytet që ka, madje unë jam i prirur më shumë për këto raste.

Sigurisht se Marku ishte në moshën më të mirë për t'i dhënë shoqërisë, ndonëse pa shumë përvojë, por me një edukatë familjare për t'u marrë shembull, me një vullnet të paepur për punën e një formim

profesional të admirueshëm. As ai, as unë nuk po kemi ndonjë arsye për të tjetërsuar realitetin, por si i thonë “i hanin duart për punë”, duke ndërë edhe kënaqësinë e të dhënit mësim, se e kishte provuar një vit brigadierlekun në kooperativë bujqësore, një sprovë dramatike e atyre viteve, të cilën e kuptojnë veç ata që e kanë jetuar e vuajtur në kurriz. Unë nuk mbaj mend ndonjëherë, ndonëse punën e kishte afër 2 orë larg, të ketë ardhur një herë vonë, të jetë ankuar e shfaqur ndonjë pretendim, pale moskockarje a nënvlerësim. Mua më ngjante si ai sportisti, që pret një shenjdhënie për të filluar garën; sado e vështirë me optimizëm e vullnet.

Pa mohuar edhe marrëdhëniet shoqërore, Marku, kur kishim ndonjë nevojë, që kërkonte disiplinë, forcë, shpejtësi, vullnet e mirëbesim, prap më ngjante si ai motori i fuqishëm që ndizet si çakmak e nuk ka të ndalur. Mbase më mirëkupton, por dua të jem sa më real: kishte shumë energji ndaj renditej ndër më të suksesshmit në punën mësimore-edukative, në pasurimin e bazës materiale e ngritjen e kabinetit, në veprimtaritë artistike e sportive etj...

Duke iu përmbajtur asaj që thashë më lart “dua të jem sa më real”, po rikujtoj ndonjë shprehje, që bëhej me shaka a me një çikëz xhelozie, ndonëse kolektivi shquhej për vlera shumë pozitive e kolektivitet. Në ndonjë rast, si nën zë thuhej se “Marku duket” a “e bën për t'u dukur”; vërtetë shquhej për pamje fizike, por bënte aq shumë punë, sa edhe po tia mohojë, ajo fliste e vërtetë dukej vetë.

Ajo bërthamë e agronomisë krijoi traditë e funksionoi si nuk ka më mirë, nuk u zhbë asnjëherë, ndaj unë kujtoj me shumë respekt

Pjetër Halilin, Pjetër Ukën, Roza Susajn e Petro Dishën, që u bënë aktor e autor të shumë arritjeve na ato vite, kur funksinoi dega e agronomisë.

... Mua nuk më befasonjë arritjet e sotshme, të cilat, megjithë modestinë e tij, flasin vetë e ato nuk mund të fshihen, një pjesë prej të cilave po kam dëshirë t'i promovoj, që të bëhen pjesë e gëzimit tonë e përvojë pozitive.

Është e ditur se fati gjithmonë ndihmon më të vullnetshmit...

Nëpërmes fitimit të një llotorie amerikane arritën në USA me 2 Qershor 2007.

Pa mohuar edhe peripecitë e shumta, në krahasim me shumë familje të tjera, familja e Markut e patën më të lehtë akomodimin e fillimit, tek miqtë e tij, kushërinjtë e Drages-tek Artan e Afërdita Vukaj nga Curraj Epër. Çdo fillim gjithëmonë është i vështirë e çdo ndihmë, kur je në vështirësi, ka shumë vlerë, qindra herë më shumë se kur je mirë. Me të drejtë u janë mirënjohës gjithë atyre që i përkrahën në ato kushte, kur çdo njeri ka nevojë për një fjalë të mirë e një dhënie dore për t'u mëkëmbur.

Fëmijët u sistemuan më herët në punë, falë moshës më të re e njohurive të admirueshme të gjuhës angleze, që mund të komunikonin pothuajse lirshëm.

Fillimi gjithmonë është i vështirë,

madje shumë i vështirë, kujton Marku nëpërmes bisedave të sinqerta, duke mos harruar as të shkuarën...

Me mdihmën e fëmijëve e një vullnet për t'u admiruar, Marku e Dragia kanë mbaruar 6 nivele të gjuhës angleze në Edmonds Comuniteti College, gja e cila i ka ndihmuar shumë për fillimin e një jete të re të integruar, një pengesë e problematike serioze që ndesh çdo emigrant.

Me të drejtë e me qytetari çmojnë mikpritjen e ngrohtë të komunitetit shqipëtar në Siatëll Uashington,-nje komunitet jo i madhe e disi i pa organizuar, por me vlera e mundësi për të ndihmuar njëri-tjetrin e për t'u afirmuar në atë botë perendimore jo fortë të njohur prej tyre, ndërsa vendasit pothuajse nuk e dinin fare se ku bie Shqipëria.

Mbështetur në aftësitë prrofesionale, në formimin e shëndoshë e atdhedashurinë e madhe që e karakterizonte prej nga vinte e dëshirën e pakufishme me shpëfaqë vlerat tona, Marku pak nga pak luan një rol të rëndësishëm, duke ndikuar për t'u njohur e organizuar me njëri-tjetrin, për t'i kompaktësuar, për të rritur frymën sociale nëpërmes formave të ndryshme, që i zotëronte mirë qysh se kur ishte mësues e aktivist shoqëror, nëpërmes takimeve të vogla e më të mëdha, drekave e darkave, veprimtarive social-kulturore e sportive, ku duhet veçuar ngritja e grupit artistik e përfaqësimi i komunitetit shqiptar në “Natën Ballkanike”, që organizohej çdo vit në Siatëll. Është një fjalë goje, por kjo veprimtari e shembulli pozitiv i familjes, që buronte nga thellësitë e zemrës, pa asnjë interes, është e një rëndësie të veçantë, që duhet vlerësuar e promovuar, përballë rasteve të tjera, që lënë për të dëshiruar... (Marku, në kohë të ndryshme, ka qenë kryetar i Bashkimeve Profesionale e zv/Sekretar i Komitetit të rinsë për Kooperativën Bujqësore Lekbibaj, ku fitoi një përvojë të mirë...)

Patjetër se, në çdo rast, çdo gjë fillon edhe nga kushtet ekonomike, pa të cilat sado zemër të bardhë të kesh e virtyte të larta, jeta nuk funksionon; megjithëse jetonin në një botë demokratike, por edhe të egër e konkurrencë për jetë a vdekje, me sproveda e peripeci të mëdha-ka funksionuar e funksionon ai parimi i mbështetjes në forcat e tua...

...Pas një viti e gjysëm qëndrimi në këtë qytet, me dakortësimin e bashkëshortes dhe fëmijëve lëvizin e vendosen në Nju Jork, afër djemëve të dajës: Lush e Pashk Gjonpali, të cilët ndihmuar shumë për t'u stabilizuar.

Arsyet e lëvizjes qenë se pëlqenin Nju Jork-un, sepse ishin më afër Shqipërisë, me një komunitet të madh shqipfolësish, me shumë të njohur, me shokë e shoqe, me një traditë e organizim shoqëror të një niveli të admirueshëm, me një veprimtari të pasur artistike, kulturore e sportive e frymë të lartë atdhedashurie.

Me gjithë këto vlera pozitive, siç duket, Siatelli kishte lënë gjurmë të veçanta, siç lenë vendlindja në vitet e para të fëmijërisë; të trashëguar nga vendlindja e të mësuar me një lloj qetësie relative për aq kohë sa jetuan aty, nuk u ndjenë komod me rrjedhën e vrullshme, pse jo edhe të rrumujshme, të qyteti famëmadh... ndonëse kishin blerë një furgon e po finalizonin hapjen një biznes modest.

Libri i Luljeta Pula - “Rrëfim i një jete për Kosovën”



Përhëndetje Prof. Luljeta Pula!

Ishte bërë një kohë e gjatë që nuk kisha marrë lajme nga Ju dhe nuk e dija gjendjen tuaj. Por fatmirësisht më erdhi libri juaj “Rrëfim i një jete për Kosovën”, për dhurimin e të cilit ju falenderoj shumë, dhe e pata fare të lehtë të kuptoja se gjendja juaj psikologjike është shumë e mirë,

pavarësisht pasojave të një harrese krejt të pajustificueshme të strukturave shtetërore dhe partiake të Kosovës e Shqipërisë. Më erdhi shumë mirë që jeni në gjendje kaq të mirë. Dhe ju falenderoj shumë që në librin tuaj bën pjesë edhe puna ime mjekësore e suksesshme në atë “mesnatë të dhimbshme të jetës” tuaj.

1. Duke lexuar me kujdes librin tuaj jam kënaqur jashtëzakonisht shumë me shqipen e pastër, me një përqindje minimale dialektesh, dhe me organizimin e bukur letrar të të gjithë faqeve të tij, çfarë me të vërtetë më befaso.

2. Me një përshkrim kaq letrar munda të kuptoj qartë patriotizmin tuaj pa kushte dhe besoj të papërsëritshëm në historinë e Kosovës, i cili përshkon tërë jetën tuaj, madje të instaluar që në kodin gjenetik. Investimi juaj në dobi të pavarësisë së Kosovës, është i pakursyer në çdo rrethandë, duke rrezikuar jo pak herë edhe jetën

Për të qenë realistë, duhet thënë se nismëtarë e iniciator, kanë qënë djemtë e Markut ... Unë e vlerësoj shumë guximin e tyre, se shpesh mësohemi me një jetë rutinë, pa kokëçarje e ambicje për më shumë arritje; por, aq shumë vlerësoj edhe përkrahjen e mbështetjen e Markut e Drages, për t’u besuar fëmijëve, relativisht të rinjë e pa shumë përvojë, për një ndërmarrje aq guximshme e të pasigurtë...

Kur u vendos të bëhej kjo lëvizje, të parët shkuan me aeroplan djemtë, si një ogur i mirë, me shpresat e energjitë që ka çdo moshë e re. Pas tyre, pa asnjë mëdyshje, prindërit, që aq mirë kishin rritur e edukuar 3 djemtë, si tre sokola, secili më i mirë se tjetri, me një vullnet të madh për punën e dashuri të madhe për nënën e babain, që gjithë jetën ua kushtuan atyre. (4 ditë rrugë me makinë, me të paktën 8 orë në ditë, me peripecitë e mundin që kërkon çdo udhëtim-janë një provë vullneti e dashurie prindërore, që duhet të frymëzojë çdo njeri).

Mbështetje e madhe për këtë familje, në atë det furtunash, ka qenë edhe Dragia-mësuesja dhe edukatoria, që trashëgoi e materializoi në jetë vlerat më të mira si bashkëshorte e si nënë, vlера të mbujtura edhe nga prindërit e saj, ndër familjet më në zë të zonës: bija e Vatë Mirash Vukajt e mbesa e Nikë Sokol Gjoklajt-nëna Lulë Sokolja).

Ky fillim, i dyti në Amerikë e i disati në jetën e tyre, ka qenë një aventurë e fortë për një jetë më të mirë, një guxim e vullnet i paepur, një optimizëm e kurajo e madhe në atë perandori vlerash, por edhe konkurrence të egër...

Duhet ta dimë se nuk do të funksiononte mirë as familja e as biznesi pa brezin e ri, pa trashëgimtarët, që janë e ardhmja e shoqërisë, pa vlerat e të cilëve nuk do të ketë ardhmëri as familja, as shoqëria; siç mora vesh, është fatbardhësi e arritje e madhe, se fëmijët e tyre, po u dalin zot biznesit e punëve, duke i respektuar e pasë parasysh edhe këshillat e përvojën e vyer

të prindërve(Klodiani, Edmondi, Riketo).

Djemtë, krahas punës, kanë mbaruar shkolla plotëuese aty në Uashington, para 1 viti i vogli, Riketo, ka mbaruar për Ekonomi biznes në Universitetin U DUB.

Në Siattle, me të ardhurat e siguruar si familje, nëpërmes punës së vazhdueshme, arritën të blejnë shtëpinë e parë, mbas tre vjetësh edhe disa të tjera, këto të realizuara në 17 vite punë.

Unë, me sa vërejtja e kuptova nga video, pashë disa banesa e një sipërfaqe toke të konsiderueshme, besoj se disa dynmëshe, pemëtore e kopshte, pa harruar edhe disa koshere me bletë e një terren sportiv multifunksional për disa sporte, pa pasur mundësi të di për makinat personale e makineritë e punës, për pajisjet e shumta e një mjedis rrethues goxha të madh, ku duket puna e palodhur e kësaj familje... Unë po due me shtue, se, patjetër është pasioni e profesionalizmi i Markut-udhëheqësi e arkitekti i këtyre arritjeve...

Pavarësisht një jetese të mirë, e ndërtuar me shumë sakrifica, nuk harrojnë të punojnë e të menaxhojnë me kujdes sukseset, duke i përforcuar e synuar për arritje të mëtejshme...

Ekonominë e jetesën i kanë në Uashington, por zemrën e mendjen e kanë në Shqipëri...” Ëndrrat i shoh në vendlindje, në Nikaj-Mërtur,-thotë Marku,- jo vetëm unë, por edhe familja. Për 17 vite-18 herë kemi ardhur në Shqipëri, duke mos-harruar për asnjë rast njerëzit tanë, me të cilët jemi të një gjaku apo të miqësuar, ku lindëm e u rritëm, me gëzime e me hidhërime, me shqetësimet e ëndërrallat si pjesë e jetës, me arritjet e dështimet, por gjithmonë bashkë e bashkë do të jemi... Me mirënjohje kujton fshatin e tij e vitet punës, duke veçuar marrëdhëniet e ndërsjella e respektin për komunitetin e krahinës e fshatin Lekbibaj ku punoi më së shumti.

Unë, që e njoh mirë, e di se ai ka aq fisnikëri e bujari, se është dalluar si individ

tuaj, të cilën nuk e mori nën mbrojtje as UÇK-ja në ato ditë tepër vështira kur “vrma e miut ishte bërë jo njëqind, por treqind grosh”.

3. Angazhimi juaj dinjitoz e i shkëlqyer mediatik, madje me trimëri e rrezikshmëri të madhe, edhe pse e vetme në mes të Beogradit, ishte shumë mbresëlënëse dhe me siguri i shtoi shumë përndjekjet e strukturave të UDB-së në Kosovë e kudo. Edhe veprimtaria juaj ndërkombëtare e vijueshme, deri në Departamentin Amerikan të Shtetit, është tepër e spikatur. Por ju e kishit ndarë mendjen një herë e mirë, prandaj nuk e ndaluan dot për asnjë çast kontributin tuaj për lirinë e kombit.

4. Duke lexuar librin mora informacion të shumë e të saktë, çfarë ma bëri të lehtë kuptimin e historisë së Kosovës, sidomos atë të mbas viteve 1981. Mund të them me bindje të plotë se libri juaj vullumoz është kontribut shumë i rëndësishëm në historinë e vërtetë të Kosovës. Dhe ajo që përjetova mbas përfundimit të librit, sidomos periudha e mbas viteve 1990, është e trishtueshme. Nuk mund të justifikoj askënd që shkeli mbi vuajtjet e mëdha nën regjimin gjakatar të Serbisë dhe mbi gjakun e derdhur lumë për lirinë e Kosovës, askënd që interesat kombëtare i vuri në shërbim të marrjes së pozitave

e si familje, por shquhet edhe sot si i tillë, kur tek shumëkush është rrudhur qesja e nuk do me ia ditë për të tjerët, jo materialisht, por ç’ është më e keqja as moralisht (ndonëse mundësitë janë më të mëdha).

Familja e tij është pjesë e arritjeve e kontributit të atij komuniteti të Palçit, me traditë e qytetari, me vizion e frymë perendimore, me vullnetin për arritje e konvergim forcash e vlerash, që kanë sjellë shumë suksese.

Marku ka një modesti, që nuk do me fol, por flasin rastet e veprat: për krijimin e disa mundësive e mbështetjen për të afërme e rrethin familjarë për të shkuar në Amerikë e për t’u punësuar apo ndihma të tjera sociale, që do të mbeten të karakterit privat e të pa publikuara asnjëherë...

Me gjithë këtë, jo gjithçka mund të mbetet “sekret”; janë shumë palçnorë e të tjerë (mes tyre Dhimitër Muslija, Afrim Gjergji, Pashk Preka, Prelë Geci), që përqafojnë e manifestojnë vlера, që dinë të punojnë e vlerësojnë pa xhelozie, që evidentojnë e janë mirënjohës për kontributin e çdonjërit në dobi të komunitetit përfshirë edhe Markun e familjen e tij:

- Për pastrimin dhe rindërtimin e rrugës Lekbibaj - Salcë
- Për meremetimin e rregullimin e rrugës së fshatit
- Për hapjen e rrugës së re Palç - bregu i Drinit(liqenit)
- Për ndërtimin e Kupolës së Kishes në Palç
- Për ndërtimin e rrugës Vranë - Curraj Epër
- Kontribut për pastrim e mirëmbajtje varrezash
- Kontribut në mbedhjen e shumave për kurim të sëmurësh
- Kontribut për zbutjen e dëmtimit të disa familjeve nga agentët atmosferik, Bardhaj - Shkodrës

Unë u gëzoja pa masë, kur Marku më tha se ka arritur të punësojë për afate sezonale a më të gjata edhe nga zonat e Veriut, madje më foli me shumë konsideratë

shtetërore apo partiake dhe të pasurimit me me çdo mjet në kurriz të popullit të vet. Atyre nuk u përket panteoni i lavdisë, por i turpit kombëtar.

5. Së fundi, dhe për të mos u zgatur shumë, lëndimi juaj shpirtor nga mosvlerësimi i “një jete kaq aktive dhe me sakrifica kaq të mëdha e tepër të rrezikshme në dobi të kombit shqiptar”, është shumë denigrues, por këtë e bëjnë ata pak njerëz që nuk meritojnë asgjë, që historia do t’ua tregojë vendin e merituar një ditë. Ndaj mendoj se ata nuk e meritojnë konsideratën dhe vëmendjen tuaj, pale më vuajtjet tuaja. Populli është ai që i mban kurdoherë dhe pa kushte në kujtesën e tij pasuritë e veta kombëtare. Dhe pa asnjë dyshim Ju jeni një nga emblemat më të denja që meritojnë plotësisht të viheni “në panteonin e përkushtimit të një jete për Kosovën”

Zonja Luljeta! Për librin tuaj mund të shkruash pa fund, por po e mbyll këtu mesazhin tim, duke ju uruar shëndet, jetë të gjatë, gëzime e lumturi familjare dhe prodhimtari të tjera letrare!

Me shumë respect!

Prof. VUKSAN KOLA

për punën e tyre. Për një moment mendova se flet për burrnin, si traditë pozitive që e kanë shumë familje fisnike; por, kur rastësia e solli e mësova nga të tjerë edhe emra, atëherë, me të drejtë, përforcova bindjen time-tradita familjare në edukim është e pazvendësueshme.

Duke e njohur e duke ia ditur edhe ‘dobësitë’ (është më mirë të them hobitëe), e ngacmoj për atë ëndërrin e dikurshme, për letërsinë e artin. Ndoshta, për mirësjellje i shmanget “debatit” për të parën, por më flet me pasion për muzikën popullore e në veçanti për atë folklorike.

Unë e ceka diku më sipër për organizimet e kontributet që ka dhënë në këtë fushë, por tani, i rrëmbyer nga pasioni, më flet më shkoqur e me emra konkret.

Nuk po flas për pasionin e tij si bletërritës as rezultatet në agronomi, në pemë frutore e perimikulturë, as për eksperimentet e rezultatet shumë të mira, por duhet veçuar e promovuar puna intensive e “hobia” në muzikë, që ua kalon edhe disave të fushës, duke sjellë vlера ideoartistike, që ndikojnë për të ruajtur lidhjet me vendin e origjinës, me traditat pozitive e ruajtjen e qetësisë shpirtërore, ku thekson më së shumti veprimtaritë (në disa reaste me mbi 400-500 veta) për Festat Patriotike e ato të Fundvitit.

E ndjen vehten mirë e të vlerësuar (ndonëse lufton për më shumë rritje cilësore) që ka performuar krahas emrave më në zë: Gëzim Nika, Shaqir Cervediku, Zef Beka, Arben Gjellushi, Shkurte Fejzo, Sabri Fejzullahu, Ylli Demaj, Artiola Toska, Meda etj...vlера që ruhen (disaprej tyre) edhe në Teknologjinë e Informimit e Komunikimit...

Mendoj se shembuj të tillë, që në themel kanë vlера pozitive, punën e ndershme e dobiprurëse, jo vetëm për vete, por edhe për komunitetin, duhen publikuar e promovuar si burim frymëzimi e atdhedashurie për sot e për nesër.

Nga FRROK VUKAJ,
Tiranë, me 07. 01. 2025

Një falënderim drejt Qiellit, për mësuesin Prekë Vukasani

Koha ka treguar se njerëzit e urtë, të rrallë e me vlera kanë lënë gjurmë tek ata, të cilët kanë pasur fatin

t'i kenë afër në jetë, të komunikojnë me ta, të punojnë dhe të mësojnë prej tyre, një ndër ta është

mësuesi, i cili mund të lërë gjurmë të pashlyeshme te nxënësi i tij. Një ndër mësuesit, i cili la gjurmë në

përjetësi te nxënësit e tij, është mësuesi Prekë Vuksani, i cili së pati fatin ta mblyllte karrierën e tij, në detyrën fisnike të mësuesit, pasi jeta u tregua e padrejtë me të.

Mësues Preka (siç e quanim atëherë), lindi në fshatin Ndrejaj, të krahinës së Shoshit, në muajin korrik të vitit 1954, ishte djali i vogël i Nikë Vuksanit dhe i Soses, vëllai i Gjelshit, Lushit, Palit, Vatës e motër Lenës.

Jetën e kaloi në fshatin e lindjes, Ndrejaj të krahinës së Shoshit, aty e filloi dhe e përfundoi karrierën e tij në funksionin fisnik të mësuesit, gjithnjë jetoi pranë familjes dhe bashkësisë, ku u rrit. Punoi për afro pesëmbëdhjetë vjet mësues në fshatin Brashtë, në të cilin la gjurmë të pashlyeshme në brezin që mësoi e edukoi.

Fati e privoi dhe ai u martua me Diellën, një bijë fisnike e një familjeje të nderuar nga fshati Brashtë, të

bijën e Linit e Lezes, dy prindër të mrekullueshëm, të cilët lindën e rritën tetë fëmijë të kulturuar e të

edukuar, edhe pse regjimi i kohës i pati persekutor politikisht e nuk i lejonte të vijonte studimet si

fëmijët e tjerë. Përkushtimi e vendosmëria e tyre ishin më të forta se çdo regjim, pasi i gjetën mënyrat

për t'i shkolluar fëmijët me çdo kusht.

Edhe Diella mbaroi shkollën për mësuesi dhe u bë mësuese, ata ishin bashkëshortë e kolegë të nderuar, që lindën e rritën dy djem, Antonin dhe Armandon, por fati e desh që ata të mos plakëshin bashkë, pasi Preka u largua nga kjo botë pabesisht me 25.shtator 2016, duke lënë në pikëllim bashkëshorten, dy djem të dhe gjithë familjen e madhe, me vëllezër, motër, nipa e mbesa, por si shpërblim la një emër që nuk do shuhet në breza, pasi u bë dritë në rrugën e diturisë për brezin e kohës.

Trashëgonte familja e Nikë Vuksanit të gjitha vlerat e një familjeje fisnike dukagjinase të kohës:

nder, burrëri, mikpritje e besë, ku fëmijët i rritën me djersën e ballit, duke ruajtur traditën dhe kulturën

e paraardhësve të tyre. Qysh i vogël ata panë te djali i tyre aftësitë dhe dëshirën për shkollim dhe e çuan

në shkollën e mesme Pedagogjike "Shenjaze Juka" në Shkodër (pasi dëshira e tij ishte të bëhej mësues),

aty ku spikati për aftësitë e talentin e rrallë dhe përfundoi ciklin e shkollës me rezultate të shkëlqyera.

Sapo mbaroi shkollën, nga Këshilli i Bashkuar i krahinës së Shoshit, u emërua mësues në fshatin Brashtë, një fshat larg

shtëpisë, afërsisht dy orë. Fillimi i karrierës së tij në detyrën e mësuesit u kthye në burim dritë e shprese për fëmijët e kësaj bashkësie, ku filloi një epokë e re për shkollimin e brezit të ri të asaj kohe, të cilët do vijonin rregullisht mësimin, pasi tashmë ai mësues rrinte shumë afër nxënësve, dukë kuptuar çdo problematikë të tyre, për ta ndryshuar jetën e secilit, që shkelte në atë shkollë. Ishte shumë i ri afër moshës 19 vjeç, kur filloi punën e mësuesit, por aspak nuk i mungonte pjekuria e aftësia të përballej me nxënës e prind, e karakterizonte kultura e dinjiteti njerëzor, ku më së miri shpaloste edhe kulturën familjare. Ishte i gjithanshëm e i kudogjendur, e gjeje në klasë, në fushë të sportit, në oborr, por edhe në shtëpi të secilit prej nesh për të kuptuar mbi çdo arsye, që fëmijët paraqitnin kur mungonin, kështu ishte bërë shumë i dashur dhe i respektuar për gjithë banorët e fshatit dhe jeta e tij ishte lidhur shumë me atë vend.



Autoriteti, serioziteti, por edhe kërkesa e llogarisë me nxënësit e tij, bënë që suksesit të harmonizohej me lumturinë në punë. Nëse çdo mësues, për arsye të ndryshme familjare mungonte ndonjë ditë, mësues Preka, asnjëherë nuk mungonte në shkollë, as atëherë kur ura e lumit ishte rrëzuar e dërrasat e saj i kishte marrë stuhia apo era e fortë, as atëherë kur bora kishte kaluar mbi një metër, ai do vinte në shkollë për të nderur zjarrin, sepse fëmijët kishin nevojë për ngrohje.

Në bashkësi ndihej i respektuar, mes miqsh i nderuar dhe mes nxënësve gjithmonë i mirëpritur e i

dashur. Puna për të nuk ishte aspak

e lodhshme, përtej vështirësive, klimës e terrenit të vështirë; sakrificat e tij ishte forcë e frymëzim për çdo fëmijë që të shkonte me dëshirë në shkollë duke sfiduar vështirësitë. Sigurisht që gjithmonë kujtohet për gjurmët që la te brezi ynë me punën e palodhur e përkushtimin e fortë në misionin e tij që e përmbushi më së miri me pasion e dashuri. Matematika-Fizika ishin lëndët që jepte në shkollë. Ora e matematikës apo gjeometrisë për çudi ishte ora më e bukur e mësimi që kalonte pa u ndier. Kur mësuesi hynte në klasë me regjistrin në dorë, asnjëherë nuk ulej në karrige, por vijimisht kontrollonte detyrat e vijonte, duke pyetur e shpjeguar mësimin. Një pyetje shkruhej vijimisht në dërrasë të zezë na shtonte kuriozitetin ..., por që atëherë nuk kuptonim tjetër përveç kureshtjes për t'ju përgjigjur, e cila na detyronte të drejtonim sy e veshë për të dëgjuar e parë

shpjegimin e mësuesit deri në detaj.

të cilët i ndihmonte për të

bërë detyrat e mësuar librat, pasi jetonte në familje te madhe.

Strategjitë e përdorura ishin të ndryshme, për të vetmin qëllim, arritjen e rezultateve të mira nga nxënësit e tij, detyrat i korrigjonte përditë, aplikonte konkursin mes klasash, na bënte veprimtari, mjaft shpesh na bënte ekskursione në natyrë, na mësonte si të ruajmë librat, fletoret e ato pak mjete që kishim, na thoshte që gjithmonë të tregohemi të sinqertë edhe kur detyrat nuk i kishim kryer siç duhej.

Fletoret e detyrave na ndrinin nga rregullsia e pastërtia edhe pse kushtet ishin mjaft të pafavorshme.

Sa lumturi do ishte nëse sot do ekzistonte ndonjë nga ato, tonat fletore, të cilat pluhuri i kohës i grisi e

humbën, sa kënaqësi do ishte për secilin prind të mund t'ia tregonte fëmijës së vet, por edhe për mësuesin t'ia tregojë nxënësit të tij, për t'i thënë: "Ja, si ishim Ne, edhe ne kishim, në kohën tonë ato që ju nuk i keni sot, por na mungonin ato që ju sot i keni". Vërtetë duhet t'i mësojmë fëmijët të mos mburren në jetë, por s'rrihet dot pa u mburrur me modelin që jeta na dhuroi ta kemi idhull, modeli që na ndriti udhën e jetës me mësimet e veta. Sa bukur është t'ia tregosh këtij brezi se koha jonë ishte e ndritur, pasi gjithçka ishte reale e jo false, ne mësuam gjithçka nga origjinaliteti, nga shpirti i pastër e i sinqertë.

Festa e mësuesit ishte një festë e thjeshtë, por e bukur. Ne nuk bënim dhurata ..., por vetëm dhuronim

lule, lule nga bjeshkët tona; trëndafil, lule të verdha e të bardha (pashke e vilikate), të cilat i bënim buqetë e klasa kundërmonte aromë bjeshke atë ditë. Lulet tona ishin kuptimi i jetës, respektit e mirënjohjes, që kishim për mësuesin, pasi mësuesi ynë nuk i pranonte dhuratat kurrsesi, duke na thënë: "Për mua dhurata më e mirë është që ju të mësoni fort e t'i dilni zot vetes, familjes e këtij vendi në të ardhmen!"

Një tufë lule me ngjyrat e ylberit, dua ta nis drejt parajsës, dedikuar mësuesit, për gjitha pranverat e jetës munguar pranë familjes, miqve e nxënësve të tij, një tufë lule për t'i thënë; "Ti mbolle lule kudo

shkele mbi këtë tokë, që tashmë ato janë rritur e do jetojnë përgjithmonë, falë asaj që Ti dhurove gjatë jetës, për t'i thënë, se ato do lulëzojnë në përjetësi!"

Ne s'i bëmë kurrë një dhuratë mësuesit tonë, por ai na la neve një dhuratë mjaft të çmuar, dijen, kulturën dhe dashurinë për librin, na mësoi, se ngjyrat e jetës i njohim dhe i shohim përmes librave që lexojmë.

Faleminderit mësues, për dritën që na fale!

Shpërblimi ardhte në familjen dhe brezit, që do mbajnë të pashuar emrin tend!

Lule Marash Bregu - Perroni

U nda nga jeta agronomi i mirënjohur Gjergj Toni

Disa ditë më parë, papritur, nga një sëmundje e rëndë, është ndarë nga jeta agronomi i njohur Gjergj Toni. Kjo vdekje ka pikëlluar thellë bashkëshorten Vojsaven, tre vajzat, nipat e mbesat, familjarët e tjerë në Nënshat të Shkodrës, ne të gjithë miqtë dhe të njohurit e tij kudo në Shqipëri dhe jashtë saj.

Gjergj Toni lindi në fshatin Neshat, Zadrimë me 12 janar 1951. Në një familje të njohur asaj zone, sidomos për lidhjen e ngushtë me kishën dhe besimin katolik. Në atë truall kanë lindur, dom Gaspër Suma "I Lumi Martir" dhe motër Marie Kaleta e nderuar me "Medaljen e Kryqit të Artë".

Gjergji, shkollën fillore dhe shtatë vjeçare i mbaroj në vendlindje. Vazhdoi Shkollën e mesme e bujqësore "Nazmi Rushiti", në Peshkopi. Atë e mbaroj me rezultate shumë të mira dhe fitoj të drejtën për studime të larta në Institutin e Larte Bujqësor Kamzë dhe u diplomua agronom në vitin 1973. Bashkoheshit e tij e njohin dhe vlerësojnë Gjergjin si një ndër studentet e mirë në mësim, si një veprimtar aktiv rinë dhe me prirje për gazetari. Të shkruarit në gazetë ishte një proces që kishte filluar që në shkollën e mesme, në gazetën "Ushtime e Maleve". Në gazetën "Studenti i Bujqësisë", në ato vite studentore, shkrimet e Gjergj Tonit ishin ndër më të pëlqyera nga studentet dhe pedagogët.

Pas diplomimit në vitin 1973, Gjergj Toni e filloi veprimtarinë si agronom i lartë në Kooperativën Bujqësore Pult-Dukagjin duke qenë i dyti agronom i lartë në këtë kooperative pas Prel Bregut nga Shala. Për ato vite që punoi në Pult ku kaloi rininë e tije s'bashkua me bashkëshorten doktoreshën Vojsava Toni, kujtohet si një nder specialistët me të aftë si agronom, si gazetar dhe si njeri i muzikës dhe humorit. Ai u bë i njohur thajse për të gjithë kooperativistët e Pultit, ku punoi si: agronom, përgjegjës sektori në Xhan dhe si kryeagronom i Kooperativës bujqësore Pult. Në ato vite nuk mbeti brigadë e ngastër bujqësore që ai nuk e shkeli me këmbë nga Qafa e Boshit në Qafë Bishkasisit, nga Karmat e Kirit në Arsa të Planit. Përveç se agronom i pasionuar, ai përfshi në jetën kulturore dhe artistike të zonës, njohës i çdo fshati i njerëzve të shquar që jetonin apo dhe atyre që përmendeshin në histori, dokeve të Pultit. Ishin këto motive që atë e frymëzuan të shkruante në ato vite shumë reportazhe, portrete, fejtone dhe shkrime historike për Pultin. Është ndoshta ndër gazetarët e parë (edhe pse nuk paguhej si gazetar) që kanë bërë të njohur Pultin në ato vite me shkrime në gazetë: "Jeta e Re", "Bashkimi", "Zëri i Popullit", e të tjera. Puna dhe veprimtari e tij në Pult, mirënjohja dhe respekti që fitoj nga njerëzit dhe kolegët e renditë atë midis intelektualëve me të shquar dhe me rezultate që kanë punuar në kooperativën Bujqësore Pult deri sa ajo u shkri.

Dhe pse kishin kaluar katër dekada që ai ishte larguar nga Pulti, teksa takoheshim dhe bisedonim tashmë në Tiranë, ai i kujtonte shumë njerëz me të cilët punoi, shumë ngjarje e vështirësi në ato vite



Gjergj Toni

që kaloi ai dhe doktoreshë Vojsava në shërbim të njerëzve. Ai gjithmonë i theksonte cilësitë e larta të banorëve të Pultit, mikpritjen dhe urtësinë e tyre, si njerëz modest, të fjalës mbajtur. Jetën në Pult Gjergji e vlerësonte si një nder periudhat më të rëndësishme të veprimtarisë tij. Ai të thoshte: Unë jam i lindur zadrimor, por jeta në Pult u bani dhe malësor pultin".

Pas transferimit nga kooperativës bujqësore Pult, Gjergj Toni ka punuar si Nënkryetar kooperative në Mjedë, një ndër kooperativat më të mëdha në

rrethin e Shkodrës. Me shkrirjen e kooperativave, ai ka punuar agronom në: Institutin e Misrit dhe Orizit, në Drejtorinë e Farave e Fidanëve në Shkodër, subjekte private, etj.

Gjergj Toni, pas viteve 2000 u transferua të jetonte, të punonte dhe shkollonte vajzat në Tiranë. Vendin e punës tij në Qendrën spitalore "Nënë Tereza" apo tek biznesi privat, e kishte kthyer një pikë takimi për shumë shkodranë dhe veçmas dukagjinat, pasi të ftonte, për kafe dhe jo vetëm. Ai ishte një njeri me zemër të madhe, bujar dhe me cilësi të larta intelektuale. Ai në çdo kohe shprehte gatishmëri dhe përkushtim për të ndihmuar me sa kishte mundësi sidomos për të marrë shërbime tek qendra spitalore. Gjithmonë, Gjergjin do ta gjeje me ndonjë shok shkollë të mesme apo fakulteti, ndonjë shkodranë apo dhe miq nga Mallakstra, Korça, Vlora, etj. pasi kishte shume njohje dhe mbante shumë lidhje shoqërore.

Pas ardhjes në Tiranë, ka punuar si përgjegjës i sektorit të administrimit të mbetjeve spitalore në Qendrën spitalore "Nënë Tereza", deri kur doli në pension në vitin 2016. Ai pas daljes në pension u mor me aktivitet privat, duke mbetur aktiv me shkrime dhe pjesëmarrës në veprimtari të ndryshme të shoqatave, etj. Në të gjitha veprimtaritë që ka zhvilluar Shoqata Dukagjini- Dega e Tiranë, ai ka marrë pjesë pasi njihet dhe kishte shoqëri thajse me të gjithë nataret e shoqatës. Ai ka qenë një lexues i rregullt i gazetës "Dukagjini" dhe i shumë botimeve të dukagjinave.

Për të përshkruar punën dhe veprim-



Gjergj Toni, Zef Gjeta, Marash Kola, Ndoc Vata.
Ne nje veprimtari te Shoqates Dukagjini ne Tirane

tarinë e agronomit Gjergj Toni, mund të shkruhej gjatë dhe nga disa njerëz që kanë punuar dhe jetuar nga afër më të, pasi ka lënë gjurmë për mirë kudo ku ai ka punuar e jetuar.

Ndarja e parakohshme dhe e papritur e Gjergj Tonit, është një humbje e madhe për familjen dhe të afërmit, ne miqtë dhe shokët. Ai realizoj disa ëndrra dhe aspirata siç ishte shkollimi i vajzave në universitet, ai gëzoj të qeni gjysh me nipa dhe mbesa, me vajzat të punësuar mirë në: Londër, Milano e Pragë. Siç thoshte, kishte planifikuar tashmë, të bënte disa botime pasi kishte shumë dorëshkrime sidomos me poezi, do i mblidhte gjithë shkrimet në gazeta të botuara në vite në një botim tjetër, e të tjera. Për dom Gasprin dhe motër Marien kishte dëshirë të realizonte një botim të veçantë, e të tjera. Këto tashmë, duket se nuk do realizohen?! Vdekja e mori papritur pa qenë i sëmurë. Gjergji kishte një natyrë shumë dashamirëse dhe njerëzit i afronte e krijonte lidhje sidomos tashmë kur vajzat u martuan dhe familja po zgjerohej. Ai çdo vit priste për pushime jo vetëm vajzat e tij me fëmijë por dhe prindërit e dhëndurëve.

Është për të theksuar një episod i veçantë që na e thanë bashkëshortja dhe vajzat :

Gjergji kërkoj me insistim që vitin ri 2025 ta festonin të gjithë së bashku në Tiranë, me tre vajzat me nipat e mbesat, me bashkëshortet, por dhe prindërit e tyre. Kjo u realizua, shumë bukur dhe kënaqësi që madhe në një darkë me shumë njerëz. Surpriza e Gjergjit që të nesërmen pra me 1 janar 2025. Ai kishte porositur një fugon për udhëtim. Të gjithë sa ishin udhëtuan drejt fshatit tij të lindjes në Nënshat. Atje, na mirëpritën njerëzit e tjerë të familjes, vëllai, kushërinjtë, e të tjerë të Gjergji. Ai ju beri një prezantim me fshatin dhe njerëzit sa ishin. Të ardhurit nga Italia, Çekia e Londra u kënaqën nga ky organizim i Gjergjit dhe mbeten të çuditur nga sa panë në fshatin e lindjes së tij. Gjergji foli gjatë, vajzat dikujt i përkthenin në çekisht, anglisht apo italisht, ai tha dhe një fjalë që nuk mori vëmendje pasi u duk si një mbyllje e zakonshme e prezantimit të tij. "Ja pra këtu është vendi ku linda dhe u rrita, por dhe kur të vije dita, dua që trupi im të prehet këtu ku kam rrënjët". Këto fjalë të thëna nga Gjergji me 1 janar 2025 për fatkeq u bënë realitet si "një amanet" me 17 janar 2025 kur trupi i Gjergj Tonit do te prehej në vendlindjen e tij Nënshat. Ishte kjo ditë që Gjergj Tonit i dhanë lamtumirën e fundit të gjithë njerëzit e tij të dashur, bashkëfshataret dhe miqtë e afërt të familjes.

Në fakt vdekja e Gjergjit u bë njohur në rrejtët sociale në datën 20 janar 2025, ku znj. Vojsava dhe vajzat në Tiranë njoftuan se presin vizita. Tek ai njoftim ka me qindra mesazhe, që shprehin ngushëllime, habi dhe keqardhje por dhe mirënjohje e dhe vlerësim për Gjergj Tonin.

I paharruar emri dhe kujtimi i Gjergj Tonit për familjarët, të afërmit dhe miqtë. I lehtë dhe i bekuar dheu që mbulon trupin e tij.

Përgatitën:

GJON FIERZA E MËHILL SHTOGU,
Tiranë, shkurt 2025

Libri "KUJTIMET E NJË USHTARAKU" nga Ndue Sanaj

RECENSION

Destojevski ka thënë: "Kur ju pushoni së lexuari libra, atëherë keni pushuar së menduari", ndaj autori i këtij libri, jo vetëm që nuk resht së lexuari, por as së shkruari.

Ashtu sikundër thonë se lumturitë nuk vijnë nga rehatitë tokësore, por vjen përmes vuajtjes ndaj e vlerëson si rrezë dielli.

- Të frymsh si njeri është e zakonshme.

- Të kontribosh me frymën e Atdhe-dashurisë është hyjnore.

- Të jesh një jetë në shërbim të mbrojtjes dhe sigurisë është gati në kufinjë e të paimagjineshmes për shkak të vështirësive e sfidave të shumta.

- Ama toka jonë arbnore, lindi djem viganë që s'ju tremb syri as u lëviz qerpiku dhe përballë vështirësive më të paimagjineshme e, malet tona i patën djemt e burrat me këto tipare.

Ndonëse kohërat dhe situatat, sistemet mund të ndryshojnë por forca, guximi, trimëria e besimi se do ia dalë nuk ka mbarim.

- Tek lexon librin "KUJTIMET E NJË USHTARAKU" nga autori Ndue Sanaj, me brendi mjaft interesante madje aq të detajuara dhe memorizuara sikur të kenë ndodhur orë më parë, dhe ky fakt e bën akoma më atraktiv këtë tekst duke i dhënë librit premisat e një romani që ta ka ënda ta rilexosh pos që teksti është mjaft voluminoz e në fakt nuk mund të përmbledhesh ndryshe një jetë me ecejaket e saj.

E megjithëse ky libër sjell aq shumë kujtime të detajuara e realitet ku mjaft histori e brendi të çmuara trajtojnë traditën e pasur ushtarake pasi fillimet janë që në antikitet si p.sh ushtritë ilire si më të shquarat e kohës qoftë në strukturë a në funksion të paqes.

Në shekujt VI- IV p.e.s, sistemi ushtarak përfshinte meshkujt e moshës 17- 20 vjeç e në kohë lufte kishin detyrim meshkujt e moshës deri në 60 vjeç.

Në këtë libër gjenden të përshkruara periudha e pushtimit vendit nga Perandoria Osmane dhe zhvillimet e detajuara në vitet 1443- 1468, apo detajet që jep për mbrojtjen ushtarake të pashalleqeve gjatë viteve 1771- 1832, kur Pashalleku i Shkodrës sundohej nga Mustafa Bushati, numri arriti në 60.000 ushtarake.

Apo Lidhja Shqiptare e Prizrenit një pikë kulmore e historisë së Shqipërisë është edhe për forcat e saj të armatosura pasi aso kohe në rrezik ishte egzistenca e vendit.

- Lidhja krijoi një ushtri vullnetare me 70.000 forca ushtarake dhe 380 batalione në Veri të Shqipërisë dhe me 100 batalione në Jug.

Megjithëse përpjekjet ishin të herëpas'herëshme shumëçka u zbeh deri në shpalljen e pavarësisë më 28 Nëntor 1912.

Në këtë tekst gjenden të dhëna për Kongresin e Lushnjës më 1920, qeverisjen e mbretit Ahmet Zogu, Lufta e Dytë

Botërore Komandanti i Ushtrisë Nacional Çlirimtare Enver Hoxha, duke përshkruar gjithashtu gjeografinë e kontinenteve të Forcave të Armatosura, në mbeshtetje të paqes, sigurisë e prosperitetit që kaloi kufinjët e rajonit Ballkanit për t'u shtrirë tej kontinentit në proceset integruese të FA dhe anëtarësimin në Nato që në Prillin e 2008 e mori në Samitin e Brukselit.

- A nuk është ky kapitull një përmbledhje e bukur dhe hulumtuese apo njohje e mirë e historisë ushtarake ndër shekuj e deri në ditët tona duke përshirë ngjarjet më historike të mbrojtjes.

Padyshim që ka dhe të tjerë, por Ndue Sanaj dua ta quaj si Rilindasin e fundit i cili ka pasuruar mjaft bukur e plot finesa trashëgiminë e këtij lloji historiko- letrarë.

Fuqia meditative kreative e autorit nuk ka qëndruar indiferent ndaj gjithë këtyre informacioneve burimore ku shtjellon në tekst mjaft mirë problemet estetike por vën edhe lidhjet e mardhëniet reciproke të cilat duken vetëm së jashtmi dhe realiteti të ndodhur, duke e sjellë të qartësuar si gjenialitet i mendimtarit.

Pra, brenda artit letrarë është krijuar në mënyrë harmonike kjo vepër mjaft e rëndësishme dhe e denjë për frymën novatore të këtij stili e cila i shërben kulturës tonë kombëtare.

Në këtë libër gjenden tema mjaft interesante, përfshi histori, bisedime, ngjarje, rrëfime proceset demokratike, etj.

Sjell disa nga temat që më kanë bërë shumë përshtypje;

- PAK HISTORI
- NË AKADEMINË E SHTABIT PËRGJITHSHËM
- KOMANDANT BATALIONI DHE SHEF SHTABI Br8S
- NË SHTABIN E DIVIZIONIT SHKODËR
- FILLIMI I PROCESEVE DEMOKRATIKE
- ZHVILLIMI I NGJARJEVE 1997
- MBYLLJA E JETËS USHTARAKE.etj.

Në vitin 1968, udhëheqja e asaj kohe i bënte sfida njëres nga fuqitë më të mëdha të kohës si Bashkimit Sovjetik, traktatit më ushtarak e më të njohur të kohës siç ishte "Traktatit Varshavës", dhe udhëheqja e asaj kohe plot patriotizëm, ishte shumë e vendosur në idealet e saj dhe nuk e ulte kurrizin as para superfuqive më të mëdha.

Ishte realitet.
Me atë akt të madh patriotizmi shteti shqiptarë jo vetëm që i bëri një akt shërbimi patriotik vendit por, edhe shteteve anëtare të NATO- s.

Gazeta "New York Times", Erik Matgollis më 1982, për ato momente të muajit Shtator 1968 shkruante; "Shqipëria aty ku po luhet me ekuilibrin e fuqive të mëdha "Lindje- Perendim:..

- Sipas gazetarit Bedri Islamit, tek artikulli "Mes Ahmetit e Enverit" botuar tek gazeta DITA datë 11 Gusht 2017, për figurën e Enver Hoxhës, analisti e gazetari italian Montanelli, që edhe pse e urrente

Enverin shkruante;

- Shqipëria në fakt, nuk kishte qënë kurrë e bashkuar, as prej race, as prej gjuhe, as prej feje. U bashkua nën Enver Hoxhën, i cili arriti atë që nuk arriti dot as Gjergj Kastrioti.

Ndoshta është më mirë mos të hetohet si i bashkoi, se kur pati në dorë vendin e tij të vogël, Hoxha luajti si të qe një Fuqi e Madhe".

A nuk të ngjan shumë luftarak ndonëse gjak ftohtë autori që ruan e mbledh esencë në thellësi të kujtesës detajet edhe më pikante ndër dekada e shekuj dhe i sjell kaq freskët në faqet e librit.?!)

Gjithashtu shton vlerat atdhetarizmit, forcës brendshme shpirtërore, fuqisë patriotshme të pushtetit, e duke nxjerrë në pah luajlitetin objektiv e subjektiv, me ndikim ndërkombëtare me qëndrime brenda shpjegimit idealist dhe pa maskë, duke e sjellë në krijimtari estetike, historiko- letrare, që iu nënshtrua edhe ligjeve specifike të kohës.

Ndaj duket qartë në kontekst idealizmi subjektiv i tipit pozitiv dhe estetik rindërtohet mbi baza teoriko- filozofike por edhe qëllim ekstremist të idealizmit.

Me interes për këtë vepër është pasqyrimi i rrjedhimëve që autori rendit në kohë pasi një pjesë e madhe vjen si dëshmi okulare e vet autorit pasi është dhe figura kryesore në vepër duke qënë përherë i thellë posaçërisht në mendim.

Në letërsinë shqipe flitet për fuqinë individuale krijuese, komponent që flet për prirjet, synimet dhe mundësitë e letërsisë poashtu.

Autori ka zgjedhur mjaft detaje të elementeve në tërësinë e atmosferës së rrëfimit që e karakterizon, i karakterizuar ndaj së kaluarës historike.

Nxitet nga të dhëna dhe të vërteta të rëndësishme e madje dhe madhështore nga e kaluara ku trajta e fakteve sipas imagjinatës krijuese të shkrimtarit shndërrohet në tërësi unike, por autori nuk e ndjen anulimin e distancës kohore duke u përpjekur të jetë realist në logjikën e rrethanave konkrete dhe thelbësore që ruan këtë madhësi, ndaj është i motivuar me vizionin e idealeve.

Ishte kultivuar një mendim i gabuar deri në udhëheqje të ushtrisë se "ata që janë në provinca pavarësisht detyrave që kishin" nuk kanë nivel të lartë drejtimi dhe nuk mund të krahasohen me ata të qytetit.

Ky mendim i gabuar bënë që Ndue të transferohej në Shkodër, por me ulje në detyrë, madje me detyrë mjaft të ulët se më para se të transferohej në Kukës, Has - Krumë në detyrën e Komandantit të Brigadës 65 të Këmbësorisë (Br65K), ndaj Ndue bëri pregatitjet e asaj metodike duke futur në punë serioze gjithë anëtarët e shtabit e armët e shërbimit Divizionit e duke përfshi Degën e Sigurimit të cilët e mbanin veten mbi të tjerët.

Me zhvillimet e ditëve që vijuan Ndue ju tregoi se si provincialët mund të opero-

jnë edhe në kushtet më të vështira pa rënë pre e nëpërkëmbjeve të askujt dhe ligjit jo e jo, kjo falë përgatitjes profesionale por dhe zgjuarsisë natyrale që karakterizohen malësorët tanë.

Natyra individuale krijuese e autorit mbështetur mbi të dhëna faktike ndër të tjera vërehet kapërcimi i pengesave, madje duke ju bërë sfidë thashethemeve e jo vetëm, pasi secilën betejë të rëndë si në mikro a makro kontekst, gjen motivet qoftë në planin e brendshëm apo në planin e raporteve të jashtme të cilat hedhin dritë të re mbi përgjegjësitë.

Ndaj autori ndriçon çdo betejë me një gazmend të ri duke mos humbur ritmin në të cilën po ashtu mund të gjenden mjaft elemente autobiografike ama ato sikur shkrihen në tërësinë e kësaj vepre dhe me mjaft sukses realizohet bukur artistikisht.

Por, dhe si profesionist i aftë e dëshmuar qartë nga koha e madje në mënyrë dinjitoze.

Autori nuk mund të mos ketë shumë nostalgji për gjithë vitet e shkuara, një jetë aktivitet pasi nuk është e vështirë që në këtë vepër të konstatohet emocionet estetike që i lidh me fenomene të madhërishtme pasi është shumë ndryshe po të bësh krahasim të emocioneve që lindin kur përceptojmë fenomene thjeshtë të bukura, ndaj të përkuarit e së madhërishtme me të bukurën që hasim në këtë libër, pasi tërësia e tij të drejton tek vlerat pozitive estetike dhe na fal kënaqësi.

Lexuar çdo faqe nga libri e trajtuar me kujdes çdo fjalë shihet delikatesa e autorit që godet fenomenet, trajton ngjarjet, vlerëson situatat, pranon e korrigjon gabime a neglizhime, duke përcjellë shumë mesazhe për brezat përmes imazheve të shumta që gjenden mundësisht edhe me ilustrime fotosh dhe emrash.

Krijuesi i këtij libri sikur vetësakrifikohej pasi nga vetja ka nxjerrë produkte të vlefshme prej mjeshtri por ua përcjell gjeneratave këtë arkivë të shpirtit autorit, pasi dhe princip ka parimet.

Ai ndonëse i ka përjetuar në jetë, bën lexuesin t'i përjetojë në lexim, edhe si proces krijues edhe si ndodhi, gjithçka vjen kulluar si perla të shpirtit autorit dhe ndodh shkrija e floririt nga skoriet gjatë përpunimit, dhe i sjell në miniaturë këtë përmbledhje kujtimesh.

Uroj që mesazhet e vyera që dalin nga ky libër të përçohen tek brezat me madhësinë e kohës ngarkuar xhevahire.

Uroj shumë dritë e refleksione autorit të librit e sa më lehtë për lexuesin e gjërë.

Udhë e mbarë librit!

**PRENDA SEJDIA,
Lezhë 31 Maj 2023**

Duke kujtuar 7- Marsin, "Ditën e Mësuesit" Urime punëtorëve të dijës!

“Edhe kur kryet do na mbulojnë thinjat, Ndermend do të sjellim një emër nderues, Emrin e dashur, emrin e bukur, emrin e thjeshtë, por të madh Mësues!...”



Shkruar nga: Fran Gjoka

Kanë kaluar plot 138 vjet nga 7 Marsi 1887. Ato mbeten vite vitale, vite përpjekësh, përkushtimi, djerse e mundimi për të lartuar shkollën e parë shqipe, shkolla më e re e shfaqur “pas përpjekjeve të mëdha të rilindësve dhe atdhetarëve në kontinentin e plakur të asaj kohe.

Por është momenti të përulemi me respekt të thellë, për ata që bënë të mundur hapjen e Mësonjëtores së Parë Shqipe të Korçës. Populli ynë rezistoi me të gjitha mënyrat. Shkrimi i shqipes u mësua fshehurazi në kasollet e fshatarëve,

shpejt mbushën malet e Shqipërisë.

Për intelektualët e shquar, gjuha dhe shkolla shqipe u bënë pikënisje e shpresës së madhe, “treveza” e parë e fundshekullit të XIX, që këtu i bashkoi shqiptarët për beteja të ardhshme. Ata lanë mënjandë dastitë fetare, krahinore e fetare dhe u bënë një për çështjen e gjuhës kombëtare.

8 Mars 1887 - Drita e së ardhmes

Mësonjëtorja e parë shqipe u hap me 35 nxënësit e parë, e më pas breza të tërë nxënësish nisën udhën e bukur të dijës në një shkollë të vërtetë shqipe. Një ditë më vonë, me 9 Mars 1887, Th. Mitkoja shkruante: *“Dëshira tonë u mbarua, shkolla shqipe u hap, druri që vumë në dhet këtu e dy vjet, sot lulëzoi dhe dha pemë të ëmbla”.*

Pas mësonjëtores së parë u hapën edhe shumë shkolla të tjera, si në Pogradec e Kolonjë, shkolla e Vashëzave në Korçë e të tjera. Asgjë s'kaloi lehtë, përkundrazi u deshën përpjekje dhe sakrificat të mëdha për të bërë përpara çdo hap në udhën e ndritur të shkollimit. Armiku reagoi shumë ashpër dhe u përpoq me të gjitha mënyrat që ta mbyste këtë dëshirë dhe luftë të madhe të shqiptarëve drejt dijeve dhe emancipimit të tyre shoqërore. Nga përplasjet me armikun e zi u flijuan shumë patriotë e atdhetarë të shquar me burgosje, vrasje e internime. P. Sotirin e hodhën nga kati i tretë i shtëpisë së tij, Papa K. Negovanin e therën me thika, Petro N. Luarasin e helmuan ... E, megjithatë mësimi në gjuhën shqipe nuk ndalej. Shkollat shqipe po ngriheshin, populli po i mbante ato në këmbë, duke hequr edhe kafshatën e fundit të gojës. Populli i duhej drita dhe atë dritë diturie e jepte vetëm shkolla. Vetëm



pranë staneve të çobanëve, në shtëpi të thjeshta, në ndërtesat e kultit e të tjera. Shikojmë aty këtu edhe ndonjë shkollë, si në Kurbin në vitet 30 të shekullit 17, në Pllanë e në Blinisht të Lezhës me 1638 dhe 1639, në Kurbin 1670, në Prizren e gjetkë. Këto shkolla patën jetë të shkurtër dhe lëvizja për hapjen e tyre ishte sporadike. U deshën të kalonin 2 shekuj, që lëvizja për shkollën dhe gjuhën shqipe të fitonte përmasa reale zhvillimi. Intelektualët tanë të shquar, që nga N. Veqilharxhi, Zef Jubani, K. Kristoforidhi, Pashko Vasa, Sami e Naim Frashëri, H. Tasimi, J. Vreto, K. Hoxhi, P. Doçi, N. Mjeda, Gj. Fishta, N. Naçi e të tjerë, edhe pse pa shtetin e tyre, pa asnjë institucion kombëtar, të drobitur pa miq e aleatë ditën të gjejnë gjuhën e bashkimit kombëtar. Abetaret e Veqilharxhit e Tasimit e të tjerë u përhapën dorë në dorë dhe u bënë shpresë për popullin dhe rininë e kohës, u bënë tmerr për pushtuesit, po aq sa pushka e komitëve, që

një populli i ditur dhe i shkolluar mund t'i bënte ballë pushtuesit dhe forcave reacionare që vepronin brenda Shqipërisë. Ndaj nga të gjithë njerëzit përparimtarë të kohës, nga atdhetarët e vërtetë hapja e shkollës së parë shqipe konsiderohej dallëndyshja e parë që lajmëronte pranverën. Dhe, dihet, dallëndyshet s'vijnë vetëm, të tjera dallëndyshe do të vinin dhe Shqipëria e shtypur dhe e masakruar në shekuj do të shikonte dritën. 8 Mars 1887 ishte fillimi i dritës që lajmëronte të ardhmen e ndritur.

Drita kërkon dritën, erdhi dita e 28 -Nëntorit 1912

Shpallja e Pavarësisë me Plakun e Vlorës dhe me Ministër i Shkollimit, Luigj Gurakuqi nxiti dhe realizoi hapjen e 70 shkollave shqipe. Për ta vijuat më me ngulm fuqizimin e shkollës kombëtare, sidomos pas Kongresit të Lushnjës më 1920 e pas luftës antifashiste nacional

çlirimtare, shkolla do të pësonte arritje të papara. Në vitet 50' do të zhdukej analfabetizmi nën moshën 40 vjeç, do të shpallej shkollimi i detyruar fillor e pastaj 7 e 8 -vjeçar. Në vitin 1957 hapet Universiteti i parë shqiptar. Universiteti i Tiranës, pas tij, Instituti e, më pas Universiteti i Shkodrës e më tej, i Elbasanit, i Gjirokastrës i Korçës, i Vlorës, Akademitë si e Shkencës, e Gjuhësisë, e Arteve të Bukura dhe Kulturës Fizike dhe Sporteve.



Në foto: I ndjeri Mark Vuji “Mësuesi i Popullit” dhe “Mësuesja e Merituar” Shpresa Bushati

7 Marsi - festë drite, festë bashkimi, festë përparimi

Me festën e 7 Marsit, janë të lidhur të gjithë: gjyshërit dhe gjyshet, baballarët dhe nënat, të rinjtë dhe të rejtat, adoleshentët dhe fëmijët e të gjithë moshave, pasi shkolla mbetet për ta institucioni i mësimi dhe i edukimit më të organizuar për nxënësit e të gjithë grupeve. Aty kultivohen vlerat e vërteta kulturore, normat morale dhe mënyrat e komunikimit njerëzor e civil. Aty mësohet dhe zbatohet parimi i demokracisë për zbatimin në unitet të të drejtave dhe lirive nga njëra ana tjetër. Në të vetmin institucion të organizuar, në shkollë dhe nga shkolla, përcillen tek gjeneratat e reja që do të drejtojnë vendin në të ardhmen mesazhe paqeje e mirëkuptimi, kultivohet toleranca dhe dëshira për të mësuar gjatë gjithë jetës në mënyrë aktive, krijuese dhe kritike.

Askush nuk lind i ditur, por bëhet i tillë në jetë

Askush nuk lind i ditur ,por bëhet i tillë në jetë duke filluar nga vatra prindërore e familjare e më pas nga bankat e shkollës,ku armata e mësuesve punon pa pushim ,skallit pak nga pak dhe pa u ndjerë mendjet e vocrrakëve dhe të rinjëve ,përsos çdo ditë ngrehinën monumentale ,intelektuale dhe shpirtërore të kombit. Këtë mësuesit e bëjnë çdo ditë pa u lodhur ,pa zhurmë, seriozitet, durim,përkushtim e fisnikëri dhe pse s'ka ende stimuj moral e material nga shteti shqiptar.

Të gjithë mësuesit ,me profesionalizmin e tyre ,duken të afërt ,sikur diku i ke takuar ,i ke njohur dhe ke bashkëbiseduar me ta,ke ndjerë ngrohtësinë ,mirësinë dhe humanizmin e tyre.Njohja me ta të bën të ndjehesh mirë ,të zgjon ide dhe kujtime

të bukura,mbresa dhe emocione respekt për jetën dhe njerëzit.Vlerat e mësuesve janë të mëdha ,me gjithë trysinë e gjithanëshme të dhunës psikologjike të ushtruar ndaj tyre dhe përsëri çdo njëri prej nesh e ndjen se ka marrë diçka prej tyre,diçka që është fiksuar fort në fëmininë tonë,në personalitetin ,në shprehitë dhe zakonet tona .Janë mësuesit ato që kapin e zbulojnë prirjet dhe talentet e nxënësve dhe kujdesën vazhdimisht ,që ata të rriten dhe

të zhvillohen më tej në drejtimin e duhur .Ndonëse brezi i mësuesve ,që janë sot në pension e kanë kryer detyrën e shenjtë ,duke dhënë të gjitha energjitë e tyre ,pasionin e profesionalizmin ,përsëri ata nuk ndjehen të qetë,ku brenda tyre zjen ndjenja e dashurisë për shkollën,arsimin e nxënësit.Kanë merak dhe mall për shkollën ,për klasën ,për zilen ,regjistrat ,kanë merak dhe mall e dashuri për nxënësit e tyre.Është ky një mall që nuk shuhet kurrë.Janë mjaft emocionuese kur kujton dhe

flitet shpesh me nderim dhe respekt për ata autoritete të arsimit, të shkencës e të pedagogjisë shqiptare ,që s'jetojnë më ,por vepra dhe ndihmesa e tyre e shquar do të mbeten të pavdekshme në kujtesën e mësuesve shqiptarë e më gjërë, siç janë : ministrat e Arsimit Naxhije Dume e Thoma Deliana, rektori i Universitetit të Tiranës Kahreman Ylli, si dhe pedagogët e mësuesit e shquar: Persa Grabova, Vasil Kamani, prof. Bedri Dedja, Emine Gjakova, prof.Jup Kastrati, Fatbardha Gega, Nazmije Pasholli, prof.Shefik Osmani, Lame Xhama “Mësuesi i Popullit” , Evanthi Ciko, prof. Mark Vuji- “Mësuesi i Popullit” etj. etj. ,të cilët me thjeshtësinë e njohur ,shpirtin e madh e bujar , edukuan e mësuan breza të tërë, nderonin njerëzit e thjeshtë të dijës dhe të kulturës ,respektonin vlerat e vërteta të mësuesisë shqiptare.

“7 Marsi” ngre zërin para politikanëve e pushtetarëve të të gjithë niveleve, intelektualëve, medias e shoqërisë civile, mbarë opinionit publik: Më shumë përkujdesje për shkollën dhe mësuesin, më shumë nderim, ndjeshmëri e mirënjohje për punën e tyre të veçantë e të lodhshme, për ata që na mësuan shkrim e këndim, matematikë e shkencë dhe që na bënë ta shohim jetën në dritë të syrit!

Ndërsa prindërve, kudo ku jetojnë e punojnë, në diasporë, në Evropë e Amerikë, në Australi e vende të tjera, “7 Marsi” u kujton se krahas punës dhe mundit për mbijetesë, mos ta harrojnë shqipen e bukur dhe t'ua mësojnë edhe fëmijëve, nipave e mbesave. Gjuha është medalion i artë i çdo shqiptari, që na njeh në botë e që na lidh e na bashkon.

Mësuesi -figura qendrore e shkollës

Parë në këtë këndvështrim, 7 Marsi i sivjetmë, që përkon me

Artisti që i bën nderë trevës Malësi e Madhe Selca, ura lidhëse mes Gjeloshit e pikturës

"Ka piktorë, që e shndrojnë dielin në një njollë të verdhë, por Ka të tjerë që përmes ndihmës së artit dhe inteligjencës së tyre, shndrojnë një pikë të verdhë në diell" - nga Pablo Picasso.

Ndoshta kjo është shtytja, që është mbrujtur në damarët e gjakut, në çdo qelizë të trupit e në gjithë hapësirën shpirtërore, që e nxitën piktorin e talentuar kelmendas, Gjelosh Mitaj Piktor, të merret me këtë art bukurie të pa zë, por që ka dhe i dhanë njohje të merituar vetës e familjes e pa dyshim Kelmendit e mbarë trevës tonë e më gjërë.

Natyrë e bukur e historitë legjendare, cilësitë njerëzore e traditat shekullore të trashëguara ndër breza, veshjet tradicionale të malësorëve si xhubleta, xhamadani e plisi i bardhë në të njëjtën valë me etno-kulturën e kudo ndodhur të Malësisë së Madhe, janë e me patjetër do bëhen edhe në të ardhmen burim frymëzimi për artistin Mitaj.

Pikërisht për ti dhënë vlerën e duhur krijimtarisë, suksesit dhe kontributit të Gjeloshit krahu punës së tij, në fushën e pictures, u mbledhëm sot në Sallën e Këshilli Bashkiak, për ta nderuar e respektuar Gjelosh Mitaj, nëpërmjet dorëzimit të titullit të lartë "Qytetarë Nderi" i Bashkisë së Malësisë së Madhe, nga vetë Kryetari i Bashkisë, z. Tonin Marinaj.

Të pranishëm në këtë ceremoni zyrtare, përveç përfaqësuesve të pushtetit e institucioneve, si Nenprefekti z. Hysen Hysaj, Z/Kryetari i Këshillit



Bashkiak, z. Mark Luli Gjellaj, Drejtori i Galerisë së Arteve në Shkodër, z. Fatmir Juka, ish-in edhe mjaft personalitete të artit e kulturës, krijimtarisë letrare e publicistikës, që me fjalët e tyre nxorrën në pah krijimtarinë me përmasa të shtrira në mbarë trojet shqiptare, si Pretash Gjekaj, Vlash Linadi, Isuf Heba, Zef Turkaj, Prele Milani e të tjerë.

Jam i bindur se, edhe familjarët e të afërmit e piktorit u ndjenë të emocionuar nga stili i të shprehurit e kultura e komunikimit dhe urimet e ardhura nga të pranishmit.

Është bindëse se ky lloj arti: "nuk e ka komunikimin e zëshëm, por me heshtjen e të parit krijon një sfond të mrekullueshëm", që për hirë të së vërtetës më pëlqen ta përshkruaj një thënie të bukur të Leonardo da Vinçit: "Piktura është një poezi që shihet e nuk dëgjohej, ndërsa poezia është një pikturë që dëgjohej por nuk shihet".

E urimi pas kësaj rezymeje vjen rrjedhshëm për këtë artist të nderuar: "Jetë, shëndet e suksese të mëtejshme piktori e tashmë "Qytetar Nderi" Gjelosh Mitaj"!

Sytki Ndreca

137 - vjetorin e hapjes së shkollës së parë shqipe, është një ngacimim disi ndryshe për faktorët dhe aktorët që e kanë detyrim ligjor, por edhe qytetar e moral për përkujdesje e vlerësim më të madh të mijëra mësuesve, që në mjaft raste punojnë në kushte ende të vështira dhe me trajtim financiar larg mundësive që ata të garantojnë jetën e tyre dhe të fëmijëve. Mësuesi është ai që të hap portat e dijes, që të orienton në lumin e madh të informacionit, që të udhëzon më mirë se kushdo tjetër sesi lexohet e punohet me librin. Ai dhe vetëm ai edhe gjërat më të vështira i bën të lehta për fëmijët. Mësuesit, në shumicën e rasteve, punojnë me pasion të veçantë e intensitet për t'i përgatitur nxënësit jo për kohën që ata

janë në bankat e shkollës, por për kohën që ata do të dalin në jetë dhe do të ndërtojnë Shqipërinë e së ardhmes, Shqipërinë e vërtetë Evropiane.

7 Marsi apelon para politikanëve e pushtetarëve të të gjithë niveleve, para medias e intelektualëve, para të gjithë opinionit: Më shumë përkujdesje për shkollën dhe mësuesit, më shumë respekt për punën e tyre të veçantë dhe të lodhshme, më shumë vlerësim për të gjithë brezat dhe para së gjithash para kontribuuesve më të mëdhenj të arsimit dhe atyre që tashmë të kërrusur nga vitet e gjata të punës në arsim presin me padurim ditën e marrjes së pensionit në sportelet me radhë të gjata! Më shumë ndjeshmëri e vlerësim material e moral për ata që na mësuan shkrim

e lexim, matematikë e kimi dhe që na orientuan të sigurt në jetë për të përballuar konkurrencën e tregut të punës!

Më shumë kujdes për ruajtjen e gjuhës së bukur dhe të vjetër shqipe nga huazimet dhe fjalët e huaja, që mund të zëvendësohen lehtësisht me fjalë shqipe! Ndërsa prindërve, kudo ku jetojnë e punojnë, në Evropë e Amerikë, në Australi e në vendet e tjera, bashkë me respektin që kemi për kontributin që ata japin edhe për zhvillimin e Shqipërisë, ju lutemi dhe në njëfarë mënyre ju përgjrohemi që tua mësojnë gjuhën shqipe edhe fëmijëve dhe nipave e mbesave! Në të kundërt gjuha jonë, ndër më të vjetrat, një ditë do të shuhet dhe kur ajo nuk flitet e shkruhet, shuhet edhe kombi, pasi gjuha është elementi kulturor

që e mban gjallë një komb. Nuk ka identitet pa gjuhë.

Festa e të gjithëve përcjell mesazhe edhe për mësuesit. Ata kurdoherë të jenë në ballë të punës për zbatimin e politikave për reformimin e shkollës, për kultivimin e vlerave demokratike tek brezi i ri, për zhvillimin e fuqisë krijuese tek nxënësit, për përfshirjen e të gjithëve në procesin e edukimit dhe të mësimin, të argëtimit dhe të zbatimit!

Në këtë ditë të shënuar nga thellësia e shpirtit tonë buron fuqishëm urimi: Gëzuar festën e dijes kolegë tanë të nderuar dhe të respektuar! Paçi gjithnjë suksese e mbarësi

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,
Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSUAN BOTIMIN
VËLLEZËRIT, ZEF,
KRISTJAN E KLADIO
PALI, ME BANIM NE
KOMUNEN CUNEO,
ITALI**

